



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE - SHKALLA E PESTË

KLASA X, XI

Shtator 2016

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	1
1 HYRJE.....	2
2 KËRKESA PËR ZBATIMIN E NIVELEVE TË ARRITJES.....	3
3 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I NIVELEVE TË ARRITJES	4
4 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”	6
4.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “GJUHË SHQIPE”	6
4.2 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “LETËRSI”	12
4.3 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “GJUHËT E HUAJA”	15
5 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “MATEMATIKË”	22
6 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “SHKENCAT E NATYRËS”	27
6.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “FIZIKË”	27
6.2 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “BIOLOGJI”	34
6.3 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “KIMI”	38
7 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “SHOQËRIA DHE MJEDISI”	42
7.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “QYTETARI”	42
7.2 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “HISTORI”	64
7.3 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “GJEOGRAFI”	69
8 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “TIK DHE TEKNOLOGJI”	73
9 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “EDUKIMI FIZIK, SPORTE DHE SHËNDETI”	78

1 HYRJE

Vlerësimi në arsim është procesi gjatë të cilit mbliidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së rezultatit të të nxënit, mbi bazën e një kriteri të caktuar. Qëllimi kryesor i vlerësimit është marrja e vendimeve, që synojnë përmirësimin e rezultateve të të nxënit dhe vetë procesin e tij. Marrja e vendimeve kërkon grumbullimin e vazhdueshëm të informacionit për të matur dhe për të vlerësuar të gjitha aspektet e procesit. Vlerësimi është pjesë integrale e të nxënit, mësimdhënies dhe programit mësimor dhe kjo sjell që qasja e sigurimit të cilësisë të zbatohet në mënyrë të barabartë gjatë vlerësimit. Në mënyrë që të sigurohet vlefshmëria dhe besueshmëria në vlerësim, duhet të rritet niveli i qëndrueshmërisë i të gjithë mësuesve dhe shkollave, gjë që realizohet nëpërmjet hartimit, mirëkuptimit dhe zbatimit të niveleve të arritjes për rezultatet e të nxënit të kompetencave.

Nivelet e arritjes shprehin kritere të njësuar për vlerësimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të nxënësve sipas fushave përkatëse. Këto nivele hartohen për të mundësuar që mësuesit të përcaktojnë arritjen e kompetencës nga nxënësi në fund të çdo viti sipas shkallëve përkatëse. Vlerësimi rigoroz bazuar në nivele të përcaktuara, krijon besim në gjykimet e mësuesve, jep siguri te prindërit dhe të tjerët që të gjithë nxënësit i kanë arritjet e tyre në përputhje me pritshmëritë.

2 KËRKESA PËR ZBATIMIN E NIVELEVE TË ARRITJES

Nivelet e arritjes bazohen në rezultatet e të nxënit të kompetencave të përcaktuara sipas shkallëve për fushat përkatëse në dokumentin e kurrikulës bërthamë. Ato përdoren nga mësuesit, hartuesit e teksteve shkollore e materialeve të tjera ndihmëse, specialistët e vlerësimit dhe inspektorët e arsimit.

Në veçanti, nivelet e arritjes ndihmojnë mësuesin për të planifikuar mësimdhënien individuale, punën e diferencuar sipas niveleve të nxënësit, për të ndikuar pozitivisht në progresin e tij dhe për të raportuar të nxëniet e nxënësit. Për të përcaktuar nivelin e arritjes së nxënësit duhen bërë një sërë vëzhgimesh dhe duhen përdorur një sërë instrumentesh vlerësimi të cilat do të shërbejnë më pas për progresin e tij.

Hartimi i instrumenteve të vlerësimit të arritjeve të të nxënit duhet kryer duke u mbështetur në nivelet e arritjeve që janë përshkruar në këtë dokument.

3 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I NIVELEVE TË ARRITJES

Në parim janë përcaktuar **katër nivele arritjeje** (1,2,3,4) të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që demonstroi nxënësi:

- niveli I (*pamjaftueshëm*);
- niveli II (*mjaftueshëm*);
- niveli III (*mirë*);
- niveli IV (*shumë mirë*);

Këto nivele korrespondojnë përkatësisht me notat: **4; 5-6; 7-8; 9-10**; të sistemit të vlerësimit me notë.

Përveç përshkrimit të profilin të përgjithshëm (diagrama 1), secili nivel është specifikuar edhe për secilën kompetencë sipas fushave¹ në përshtatje me rezultatet përkatëse të të nxënësit, në përfundim të shkallës 5 (klasa 10-11).

Tabela 1: Nivelet e arritjes së kompetencave dhe përshkrimi i tyre

NIVELI I (Notat 4)	NIVELI II (Notat 5-6)	NIVELI III (Notat 7-8)	NIVELI IV (Nota 9-10)
Nxënësit në këtë nivel demonstrojnë një shkallë të pamjaftueshme të zotërimit dhe zbatimit të	Nxënësit në këtë nivel zotërojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime duke i demonstruar ato në situata të përcaktuara/të njohura; ata kryejnë detyra	Nxënësit në këtë nivel zotërojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime duke i demonstruar ato në situata analoge ose të ngjashme; ata shprehin qëndrimin e tyre personal, duke vepruar më shumë në nivelin e	Nxënësit në këtë nivel zotërojnë njohuri, aftësi, qëndrime duke i demonstruar ato në mënyrë të pavarur dhe krijuese, në situata të reja dhe të panjohura për ta; ata janë të aftë të zgjidhin situata

¹ Në varësi të specifikave të fushës dhe lëndëve përkatëse, nivelet e arritjes mund të hartohen për fushë ose për lëndë



njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve.	lëndore sipas modeleve të ofruara.	pohimeve dhe konkluzioneve të formuluar se sa në nivel analize.	problemore të ndryshme, të mbrojnë pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre bazuar në argumente.
---	------------------------------------	---	---



4 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”

4.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “GJUHË SHQIPE”

SHKALLA V		
Kompetenca I: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme		
Përshkrimi i kompetencës: Gjatë arsimit të mesëm të lartë, nxënësit reflektojnë ndaj informacioneve të llojeve dhe të fushave të ndryshme; përmbledhin, parafrzojnë dhe vlerësojnë përmbajtjen e informacionit të dëgjuar; analizojnë stilin dhe strukturën e një fjalie ose të një teksti të dëgjuar; përqendrohen te folësi, diskutojnë dhe zgjerojnë idetë e dëgjura; mbajnë shënime të tilla që demonstrojnë të dëgjuarit e qëllimshëm etj.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ kupton tekste të llojeve të ndryshme; ➤ dallon tiparet kryesore të formës e të përmbajtjes së teksteve; ➤ dallon kuptimet e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti; ➤ identifikon faktet dhe opinionet në tekste të ndryshme; ➤ identifikon mjetet që përdor folësi për ta bërë tërheqëse ose të besueshme të folurën e tij.	Nxënësi: ➤ përdor strategjitë e të dëgjuarit dhe analizon tekste të llojeve të ndryshme; ➤ analizon tiparet e formës e të përmbajtjes së teksteve; ➤ zbulon kuptimin e fjalës duke hetuar mbi origjinën e saj, interpreton kuptimet e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti; ➤ analizon gjuhën e figurshme të tekstit; ➤ analizon pjesërisht faktet dhe opinionet në tekste të ndryshme;	Nxënësi: ➤ përdor strategjitë e të dëgjuarit dhe vlerëson tekste të llojeve të ndryshme; ➤ gjykon dhe vlerëson tiparet e formës e të përmbajtjes së teksteve; ➤ zbulon kuptimin e fjalës duke hetuar mbi origjinën e saj, analizon dhe interpreton kuptimet e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti;



	➤ analizon mjetet që përdor folësi për ta bërë tërheqëse ose të besueshme të folurën e tij.	➤ përdor materiale udhëzuese dhe hulumton në leksikun e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin; ➤ vlerëson gjuhën e figurshme të tekstit; ➤ analizon faktet dhe opinionet që përdor autori në tekste të ndryshme; ➤ vlerëson mjetet që përdor folësi për ta bërë tërheqëse ose të besueshme të folurin e tij; ➤ gjykon me fakte rreth vërtetësisë së tekstit.
Kompetenca II: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar		
Përshkrimi i kompetencës: Të folurit është mjeti themelor i komunikimit me të tjerët dhe gur themeli i të mësuarit në të gjitha lëndët mësimore. Duke folur dhe duke biseduar nxënësit jo vetëm japin informacion, por edhe sqarojnë kuptimin dhe domethënien e koncepteve të ndryshme, identifikojnë dhe zgjidhin probleme, zgjerojnë njohuritë, si dhe shprehin mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tyre. Kur ata diskutojnë rreth një informacioni, njohin dhe pranojnë edhe këndvështrimet e bashkëbiseduesve të tjerë, si dhe mjetet gjuhësore apo stilin që ata përdorin. Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit përmirësojnë aftësitë e tyre për të komunikuar dhe për të prezantuar ide në klasë dhe në situata formale. Nëpërmjet këtyre situatave, nxënësit aftësohen edhe për të folurit në publik. Ata mësojnë të flasin qartë, bindshëm e me vetëbesim dhe të jenë tërheqës për të tjerët: duke përdorur gjuhën standarde, sidomos kur këtë e dikton situata dhe dëgjuesit; duke diskutuar në grupe të vogla dhe të mëdha; duke marrë role të ndryshme në menaxhimin dhe në moderimin e diskutimeve dhe debateve; duke përfshirë e angazhuar të tjerët për të përmbushur afatet dhe qëllimet; duke respektuar, gjatë prezantimeve me gojë, karakteristikat e një fjalimi, shpjegimi, raportimi, debati etj.; duke përzgjedhur fjalët e fjalitë e përshtatshme dhe duke përdorur mjete retorike e të figurshme; duke përdorur dhe duke vlerësuar TIK-un gjatë prezantimeve në aktivitete të ndryshme në shkollë dhe jashtë saj.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: ➤ shpreh mendimet dhe idetë e tij në diskutime për tema të ndryshme; ➤ dallon karakteristikat e gjuhës së folur si një formë komunikimi; ➤ identifikon tiparet e prezantimeve të ndryshme me gojë, si dhe bën një prezantim të thjeshtë para klasës; ➤ përdor TIK-un për të realizuar një prezantim të thjeshtë.	Nxënësi: ➤ merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme, mbështet një pozicion të caktuar, merr në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim; ➤ analizon karakteristikat e gjuhës së folur si një formë komunikimi, si dhe krahason përdorimet e kësaj gjuhe në shkollë dhe në komunitet; ➤ realizon prezantime të ndryshme me gojë, përdor disa strategji për të përmbushur qëllimin dhe për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës; ➤ përdor pjesërisht TIK-un për të realizuar prezantime të ndryshme, sidomos në situata formale.	Nxënësi: ➤ merr pjesë aktive në diskutime për tema të ndryshme, mbështet ose kundërshton me argumente bindëse një pozicion të caktuar, merr në konsideratë qëllimin, audiencën dhe situatën në një diskutim, si dhe përmbledh përfundimet e një diskutimi; ➤ analizon dhe gjykon për karakteristikat e gjuhës së folur si një formë komunikimi, si dhe krahason përdorimet e kësaj gjuhe në shkollë dhe në komunitet; ➤ realizon prezantime të ndryshme me gojë, përdor strategjitë e duhura për të përmbushur qëllimin dhe për të tërhequr vëmendjen dhe interesin e audiencës, respekton kohën gjatë prezantimit; ➤ përdor TIK-un për të realizuar prezantime të ndryshme, sidomos në situata formale, si dhe vlerëson rolin e tij në këto prezantime.
Kompetenca III: Të lexuarit e teksteve të ndryshme		



Përshkrimi i kompetencës:

Edhe pse disa nxënës që hyjnë në klasën e dhjetë, janë lexues të pavarur, shumë prej tyre mund të kenë nevojë për mbështetje, me qëllim që të zhvillojnë më tej aftësitë në lexim. Pra, ky proces duhet të vijojë edhe në arsimin e mesëm të lartë. Përveç kësaj, të gjithë nxënësit përballen me sfidat që shtron programi i gjuhës shqipe, i cili kërkon nga nxënësit të përvetësojnë koncepte gjithnjë e më abstrakte, të përdorin struktura gjuhësore më komplekse, si dhe të kenë fjalor më të pasur se në arsimin bazë.

Lënda e gjuhës shqipe i ndihmon nxënësit që të lexojnë në mënyrë aktive dhe kritike, si dhe ta përthithin mirë e shpejt informacionin. Një lexues aktiv dhe kritik është ai që jo vetëm i kupton njohuritë që komunikohen në një tekst, por edhe i përdor ato në kontekste të reja. Për ta realizuar këtë, nxënësit zbatojnë një sërë strategjish të të kuptuarit, si dhe njihen me një shumëllojshmëri tekstesh. Njohja me tekste të ndryshme u jep mundësinë nxënësve që të zbulojnë interesat dhe prirjet e tyre dhe, gjithashtu, ta kenë më të lehtë të zgjedhin orientimin e karrierës së tyre.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ identifikon tiparet kryesore të formës e të përmbajtjes së teksteve; ➤ përdor organizuesit grafikë në funksion të procesit të të kuptuarit të tekstit; ➤ kupton tekste të llojeve të ndryshme; ➤ dallon kuptimet e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti; ➤ identifikon, në përgjithësi, faktet dhe opinionet në tekste të ndryshme; ➤ mbledh informacione për qëllime të ndryshme dhe përmbledh idetë kryesore të tyre.	Nxënësi: ➤ analizon tiparet kryesore të formës e të përmbajtjes së teksteve; ➤ përdor organizuesit grafikë në funksion të procesit të të kuptuarit të tekstit, parafrazon dhe përmbledh shkurtime të tekstet e punuara; ➤ analizon tekste të llojeve të ndryshme; ➤ zbulon kuptimin e fjalës duke hetuar mbi origjinën e saj, interpreton kuptimet e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti; ➤ përdor materiale udhëzuese dhe gjurmon në leksikun e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin;	Nxënësi: ➤ përdor strategjitë e të lexuarit dhe gjykon për tiparet e formës e të përmbajtjes së teksteve; ➤ përdor organizuesit grafikë në funksion të procesit të të kuptuarit të tekstit, parafrazon dhe përmbledh tekstet e punuara; ➤ gjykon dhe vlerëson tekste të llojeve të ndryshme; ➤ zbulon kuptimin e fjalës duke hetuar mbi origjinën e saj, analizon dhe interpreton kuptimet e dyta dhe të figurshme që merr fjala brenda një konteksti;



	➤ analizon, në përgjithësi, faktet dhe opinionet në tekste të ndryshme; ➤ përzgjedh informacione për qëllime të ndryshme, analizon informacionin e përzgjedhur nga të tjerët, përmbledh materiale të ndryshme, si dhe nxjerr disa përfundime.	➤ përdor materiale udhëzuese dhe gjurmon në leksikun e teksteve të ndryshme për të pasuruar fjalorin; ➤ analizon faktin dhe opinionin në tekste të ndryshme; ➤ realizon punë kërkimore, përzgjedh informacione për qëllime të ndryshme, vlerëson informacionin e përzgjedhur nga të tjerët, përmbledh materiale të ndryshme, si dhe nxjerr përfundime.
Kompetenca IV: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		
Përshkrimi i kompetencës: Të shkruarit u jep mundësi nxënësve të mësojnë për veten e tyre dhe të lidhen me botën. Një nga qëllimet e programit të gjuhës shqipe është që nxënësit të demonstrojnë siguri dhe saktësi kur shkruajnë, të hulumtojnë para se të shkruajnë një tekst, si dhe të komunikojnë me kompetencë, duke përdorur forma dhe stile të ndryshme të shkruarit. Gjatë tri viteve, nxënësit krijojnë, organizojnë dhe përzgjedhin ide për të shkruar për qëllime, audienca dhe situata të ndryshme. Ata zbatojnë hapat e domosdoshëm të procesit të shkrimit (planifikimi, organizimi i punës me shkrim, rishikimi, redaktimi etj.). Nxënësit zbatojnë, gjatë të shkruarit, karakteristikat e teksteve dhe rregullat gramatikore e drejtshkrimore.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ njeh hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit dhe organizon mendimet dhe idetë e tij në një strukturë të thjeshtë; ➤ shkruan qartë, tekste të thjeshta, për qëllime të ndryshme;	Nxënësi: ➤ realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit, përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij, organizon mirë mendimet dhe idetë, redakton mirë shkrimin e tij;	Nxënësi: ➤ realizon hapat e përcaktuar dhe të domosdoshëm gjatë të shkruarit, përdor strategji të ndryshme për të planifikuar shkrimin e tij, organizon në mënyrë logjike mendimet dhe idetë,



➤ shkruan tekste të llojeve të ndryshme për qëllime personale dhe funksionale, duke respektuar kriteret kryesore për secilin lloj (formë); ➤ zbaton, në përgjithësi, rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit në shkrimet e tij dhe në procesin e redaktimit.	➤ shkruan qartë dhe në mënyrë logjike, tekste për qëllime dhe për audienca të ndryshme; ➤ shkruan mirë tekste të llojeve të ndryshme për qëllime personale dhe funksionale, duke zbatuar kriteret e domosdoshme për secilin lloj (formë); ➤ zbaton mirë rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit në shkrimet e tij dhe në procesin e redaktimit; ➤ përdor disa materiale burimore që e ndihmojnë gjatë procesit të shkrimit.	redakton shkrimin duke përdorur edhe mendimet e të tjerëve; ➤ shkruan qartë, me një stil vetjak dhe në mënyrë logjike, tekste për qëllime dhe për audienca të ndryshme; ➤ shkruan saktë tekste të llojeve të ndryshme për qëllime personale dhe funksionale, duke zbatuar kriteret për secilin lloj (formë); ➤ zbaton me saktësi rregullat gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit në shkrimet e tij dhe në procesin e redaktimit; ➤ përdor materiale të ndryshme e të shumëllojshme burimore që e ndihmojnë gjatë procesit të shkrimit.
Kompetenca V: Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit		
Përshkrimi i kompetencës: Në arsimin e mesëm të lartë, nxënësit demonstrojnë ndërgjegjësim dhe saktësi në përdorimin e njohurive rreth sistemit gjuhësor të shqipes. Ata i konsolidojnë njohuritë gjuhësore, aftësohen ta përdorin gjuhën saktë dhe brenda rregullave gramatikore. Nxënësit i përdorin njohuritë gjuhësore për të organizuar, për të redaktuar dhe për të përmirësuar shkrimet e tyre, për të folur qartë dhe saktë, për të gjykuar gjuhën e një teksti që dëgjojnë ose lexojnë etj. Në këtë cikël, nxënësit përcaktojnë dallimet mes gjuhës së folur e gjuhës së shkruar, analizojnë regjistrat e gjuhës, vlerësojnë pasurinë leksikore të gjuhës shqipe dhe zbatojnë rregullat drejtshkrimore dhe të pikësimit.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: ➤ zotëron njohuri kryesore rreth gramatikës dhe leksikologjisë; ➤ dallon tiparet e gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, të regjistrave formalë dhe joformalë, të dialekteve dhe të gjuhës standarde; ➤ njeh rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit në gjuhën shqipe; ➤ shkruan saktë dhe, kryesisht, pa gabime drejtshkrimore; ➤ përdor mirë terminologjinë gjuhësore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.	Nxënësi: ➤ përdor, në përgjithësi, njohuritë gramatikore dhe leksikore gjatë të folurit dhe të shkruarit për të arritur qëllime ose efekte të caktuara; ➤ dallon ndryshimet kryesore mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, mes dialekteve dhe gjuhës standarde; ➤ zotëron mirë rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit në gjuhën shqipe; ➤ shkruan saktë, pa gabime, duke cituar rregullat drejtshkrimore; ➤ përdor terminologjinë gjuhësore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.	Nxënësi: ➤ zotëron njohuri të reja rreth gramatikës dhe leksikologjisë përmes studimit të funksionit të tyre në tekstet që lexon; ➤ përdor me saktësi, njohuritë gramatikore dhe leksikore gjatë të folurit dhe të shkruarit për të arritur qëllime ose efekte të caktuara; ➤ dallon dhe përdor ndryshimet mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar, mes regjistrave formalë dhe joformalë, mes dialekteve dhe gjuhës standarde; ➤ zotëron shumë mirë rregullat e drejtshkrimit dhe të pikësimit në gjuhën shqipe; ➤ shkruan saktë, pa gabime, dhe argumenton mënyrën e të shkruarit, duke cituar rregullat drejtshkrimore; ➤ përdor me saktësi terminologjinë gjuhësore në diskutime gjatë të folurit dhe kur shkruan.
---	---	---

4.2 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “LETËRSI”



SHKALLA V

Kompetenca I: Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare

Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësit fitojnë teknikat e analizës së veprave letrare, të cilat do t'u shërbejnë në shkollë dhe në jetë. Ata analizojnë dhe interpretojnë, si lexues kritikë dhe të pavarur, vepra të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare. Duke studiuar tiparet kryesore të gjinive dhe të llojeve letrare, nxënësit marrin njohuritë dhe fitojnë aftësitë e nevojshme për ta kuptuar më mirë natyrën e letërsisë. Këto tipare, nxënësi nuk i mëson thjesht në mënyrë teorike, por të konkretizuara në veprat ose fragmentet letrare. Gjatë tri viteve, nxënësit do të lexojnë dhe do të punojnë me tekste poetike, dramatike dhe tekste në prozë.

Gjatë analizës dhe interpretimit të veprave letrare, nxënësit dallojnë edhe mjetet e shumta e gjuhës, të cilat janë përdorur për të krijuar tekste jo vetëm me kuptim, por edhe estetikisht të bukura.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ identifikon elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti në prozë si: tema dhe motivet, idetë, përshkrimi i kohës dhe i mjedisit, rrëfimtari, marrëdhëniet mes personazheve, fabula dhe subjekti etj.; ➤ identifikon elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti poetik si: motivet kryesore, përdorimi i gjuhës, figuracioni, rima, ritmi, llojet e strofës etj.; ➤ dallon elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti dramatik si: trajtimi i temës, konfliktet e përshkruara në vepër,	Nxënësi: ➤ analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti në prozë si: tema dhe motivet, idetë, përshkrimi i kohës dhe i mjedisit, rrëfimtari, marrëdhëniet mes personazheve, fabula dhe subjekti etj.; ➤ analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti poetik si: motivet kryesore, përdorimi i gjuhës, figuracioni, rima, ritmi, llojet e strofës etj.; ➤ analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti	Nxënësi: ➤ gjykon dhe vlerëson elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti në prozë si: tema dhe motivet, idetë, përshkrimi i kohës dhe i mjedisit, rrëfimtari, marrëdhëniet mes personazheve, fabula dhe subjekti; ➤ gjykon dhe vlerëson elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti poetik si: motivet kryesore, përdorimi i gjuhës, figuracioni, rima, ritmi, llojet e strofës etj.; ➤ gjykon dhe vlerëson elementet e përmbajtjes dhe të formës së një teksti dramatik si: trajtimi i temës, konfliktet



Faqe14 nga 82



dhe romake, letërsia e Rilindjes Evropiane, letërsia e vjetër shqipe dhe klasicizmi, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe veprat dhe autorët më përfaqësues; ➤ dallon tiparet kryesore të romantizmit dhe të realizmit; ➤ identifikon kushtet kryesore historike në të cilat u zhvillua romantizmi dhe realizmi, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe veprat dhe autorët më përfaqësues.	Evropiane, të letërsisë së vjetër shqipe dhe të klasicizmit; ➤ analizon periudhat historike në të cilat u zhvillua letërsia antike greke dhe romake, letërsia e Rilindjes Evropiane, letërsia e vjetër shqipe dhe klasicizmi, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe veprat dhe autorët më përfaqësues; ➤ analizon tiparet kryesore të romantizmit dhe të realizmit; ➤ analizon periudhat historike në të cilat u zhvillua romantizmi dhe realizmi, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe veprat dhe autorët më përfaqësues; ➤ identifikon vlerat e letërsisë shqipe dhe asaj botërore.	Rilindjes Evropiane, të letërsisë së vjetër shqipe dhe të klasicizmit; ➤ gjykon për periudhat historike në të cilat u zhvillua letërsia antike greke dhe romake, letërsia e Rilindjes Evropiane, letërsia e vjetër shqipe dhe klasicizmi, për gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe për veprat dhe autorët më përfaqësues; ➤ komenton dhe vlerëson tiparet kryesore të romantizmit dhe të realizmit; ➤ gjykon për periudhat historike në të cilat u zhvillua romantizmi dhe realizmi, për gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan, si dhe për veprat dhe autorët më përfaqësues; ➤ krahason vlerat e letërsisë shqipe dhe asaj botërore; ➤ gjykon për vlerat njerëzore, etike dhe estetike që gjejnë shprehje në krijimtarinë letrare, si dhe shpjegon preferencat ose pëlqimet e tij në letërsi.
--	--	--

4.3 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “GJUHËT E HUAJA”



SHKALLA V

Nivelet e arritjes janë përcaktuar duke u mbështetur tek Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave (KPER) për gjuhët. Nxënësi në përfundim të shkallës V, e cila përkon me klasën e XI, duhet të ketë arritur nivelin B 1+.

Më poshtë jepet përshkrimi i nivelit B1 sipas shkallës globale të KPER.

“Nxënësi kupton pikat themelore kur përdoret gjuhë e qartë dhe standarde për tema të zakonshme në shkollë, punë, kohën e lirë etj. Ai ia del mbanë në shumicën e situatave me të cilat ndeshet gjatë udhëtimit në një vend ku flitet gjuha që ai po mëson. Nxënësi prodhon një ligjëratë të thjeshtë dhe koherente mbi tema të njohura dhe të fushave që shprehin interes për të. Ai tregon ngjarje, përshkruan përvoja, ëndrra, ose shpresa dhe paraqet shkurt arsye dhe shpjegime për opinionet dhe planet e tij.”

Kompetenca I: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi kupton pikat themelore kur përdoret gjuhë e qartë dhe standarde kur flitet për tema të njohura që kanë lidhje me shkollën, kohën e lirë. Ai kupton thelbin e një numri emisionesh në radio/ televizion mbi aktualitetin ose mbi tema që i interesojnë drejtpërdrejt, nëse e folura është relativisht e qartë dhe e ngadaltë.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ dëgjon dhe kupton një informacion të drejtpërdrejtë mbi fakte të jetës së përditshme (jeta në shkollë, koha e lirë); ➤ reagon në biseda të përditshme të shqiptuara qartë dhe shpesh kërkon përsëritje të fjalëve dhe shprehjeve të veçanta; ➤ kupton informacion të thjeshtë teknik (si të vërë në punë një paisje të thjeshtë);	Nxënësi: ➤ lidh temën kryesore me detajet e një informacioni që dëgjon; ➤ ndjek pa shumë vështirësi një bisedë të zgjeruar ku artikulumit është i qartë dhe standard; ➤ demonstroi me shembuj dhe veprime të kuptuarin e udhëzimeve të ndryshme teknike;	Nxënësi: ➤ ndan pa vështirësi detajet e rëndësishme nga ato më pak të rëndësishme në një informacion që dëgjon; ➤ krahason njohuritë e marra me ato që merr gjatë dëgjimit të një emisioni në radio/televizion;



➤ dëgjon dhe ndjek me vështirësi informacion të regjistruar në audio CD/radio/televizion mbi tema që ai/ajo i di dhe ka interes mjafton që e folura të jetë standarde dhe relativisht e thjeshtë; ➤ identifikon pikat kryesore të një emisioni televiziv kur e folura është relativisht e ngadaltë.	➤ ndjek filma ku pamja vizuale dhe veprimet e ndihmojnë për të kuptuarin; ➤ përzgjedh informacion të regjistruar në audio CD/radio/televizion mbi tema që ai/ajo i di dhe ka interes mjafton që e folura të jetë standarde dhe relativisht e thjeshtë.	➤ vlerëson informacionin që dëgjon në një emision televiziv ku e folura është relativisht e ngadaltë; ➤ parashikon informacionin e regjistruar në CD që do dëgjojë duke u mbështetur në njohuritë e mëparshme.
--	---	---

Kompetenca II : Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përballon shumicën e situatave në të cilat mund të gjendet gjatë një udhëtimi në vendet ku flitet gjuha . Ai merr pjesë pa u përgatitur në një bisedë të njohur ose të interesit personal. Nxënësi tregon thjesht një histori, film, përshkruan ngjarje si edhe jep arsyet për qëndrimet dhe opinionet e tij.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ shpreh ndjenja (gëzim, hidhërim, habi etj) duke ndjekur një model të qartë dhe të thjeshtë; ➤ merr pjesë në një diskutim dhe përpiqet të japë ose marrë opinion me fjali të thjeshta; ➤ përdor një pyetësor të parapërgatitur për të marrë pjesë në një intervistë;	Nxënësi: ➤ shfrytëzon një gamë të gjerë fjalori të thjeshtë kur merr pjesë në biseda të interesit të përditshëm, (familja, hobi, udhëtimet etj); ➤ demonstroi gatishmëri për të marrë pjesë në diskutim por disa herë i duhet të kërkojë sqarime dhe ndihmë; ➤ komenton shkurt dhe thjeshtë mbi opinionet e bashkëfolësit;	Nxënësi: ➤ manipulon me njohuritë që zotëron dhe hyn i papërgatitur në një bisedë rreth fushave të tij të interesit; ➤ interpreton thjeshtë mendimet e tij mbi tema abstrakte dhe kulturore (muzika, filmi etj.); ➤ krahason alternativa të ndryshme kur diskuton se çfarë të bëjë, ku të shkojë, kë të zgjedhë etj.; ➤ jep zgjidhje problemeve praktike në një diskutim duke qenë i qartë për ato që thotë. (organizimi i një eventit etj.);



➤ riprodhon tekste të shkurtra përshkrues (histori, ngjarje); ➤ përdor modelet e dhëna për të shprehur besim, marrëveshje, opinione etj.; ➤ i kërkon bashkëfolësit të përsërisë në mënyrë të saktë e më të qartë atë çka po thotë; ➤ mban mend dhe i përsërit shprehjet e përdorura për të dhënë orientime.	➤ shpreh mendimin e tij mbi tema kulturore (film, muzikë etj); ➤ merr pjesë në diskutime ku jepen udhëzime pa përdorur shprehje idiomatike; ➤ përmbledh një material (histori, tregim, artikull, bisedë, intervistë, dokumentar) si edhe pyet dhe përgjigjet për këtë material; ➤ eksperimenton me fjalorin e mësuar për të ndërtuar dialogje/intervista të ndryshme (tek doktori/në kinema etj).	➤ vë në dukje qartë idetë që trajton në një diskutim; ➤ shpjegon me detaje të qarta dhe të sakta se si mund të kryhet një veprim; ➤ analizon me detaje dhe i bën përmbledhjen një materiali. (histori, tregim, artikull, bisedë, intervistë, dokumentar) dhe mban qëndrimin e tij; ➤ fillon një bisedë ose intervistë , fton të tjerët të shprehin mendimet e tyre etj.
--	--	--

Kompetenca II: Të lexuarit e teksteve të ndryshme

Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi kupton tekste të hartuara kryesisht mbi ngjarje të jetës dhe punës së përditshme si edhe të fushave të tij të interesit. Ai kupton përshkrimin e ngjarjeve, ndjenjave dhe urimeve në letra personale.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ gjen dhe kupton informacionin e përshtatshëm në materiale të jetës së përditshme. (letra, broshura, dokumenta të shkurtër zyrtarë);	Nxënësi: ➤ kupton përshkrimin e ngjarjeve , ndjenjave dhe dëshirave në letra korrespondencë me njerëzit, që e rrethojnë;	Nxënësi: ➤ zbulon nënkuptimin e fjalëve dhe fjalive në një pjesë leximi; ➤ analizon përmbajtjen dhe strukturën e një pjese leximi. (tregim, letër, dokument zyrtar);



➤ identifikon pikat kryesore në një artikull të thjeshtë gazete për tema aktuale dhe kupton në mënyrë të përgjithshme thelbin e informacionit; ➤ liston hapat që ndiqen për përdorimin e një paisjeje elektronike; ➤ ndan në paragrafë një tregim; ➤ kombinon idenë e paragrafit me paragrafin në një letër ose tregim; ➤ identifikon idenë kryesore të një pjese leximi.	➤ zgjedh informacionin që dëshiron nga tekste të ndryshëm për të kryer detyrën që i ngarkohet; ➤ dallon linjën e një argumenti në problemet e trajtuara; ➤ zbulon kuptimin figurativ të disa shprehjeve idiomatike; ➤ citon shembuj nga teksti për të mbështetur mendimin e tij; ➤ skicon organizimin e një paragrafi ose teksti.	➤ shqyrton një ose disa pjesë të gjata leximi dhe gjen informacionet e duhura për detyrat e caktuara; ➤ kupton në nivel të kënaqshëm tekste faktike të mirëfillta që lidhen me interesin e tij; ➤ kupton udhëzime, manuale të thjeshta për përdorimin e pajisjeve elektro-shtëpiake, të telefonit etj.; ➤ analizon konkluzionet në pjesë leximi argumentuese; ➤ organizon materialet e lexuara në skema të ndryshme kuptimore.
---	---	--

Kompetenca III: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi shkruan një tekst të thjeshtë dhe koherent mbi tema të njohura ose të fushës së tij të interesit. Ai shkruan letra personale për të përshkruar përvojat dhe përshtypjet.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ kopjon modele të gatshme për të shkruar një letër/ e-mail/ tregim të shkurtër ku përshkruan një përvojë personale me pak detaje;	Nxënësi: ➤ transmeton qartë mendimet, përshkrimet, qëllimin e tij në letra/ e-mail personale; ➤ harton letër/e-mail ku shpreh mendimin e tij për tema kulturore (muzikë, film);	Nxënësi: ➤ përcjell informacionin dhe idetë e tij shumë qartë mbi tema konkrete dhe abstrakte; ➤ harton letër/e-mail ku shpreh mendimin e tij për tema kulturore dhe abstrakte;



➤ shkruan mesazhe komunikimi të thjeshta dhe të shkurtra; ➤ riprodhon fjali të shkëputura për të përshkruar përvoja dhe ndenja personale; ➤ tenton të lidhë fjali në një paragraf të shkurtër; ➤ përshkruan një ngjarje, një udhëtim real, ose imagjinar me fjali të thjeshta psh për një gazetë shkolle; ➤ përdor TIK-un në prezantimet e detyrave dhe projekteve.	➤ shpjegon qartë pikat më të rëndësishme në një mesazh; ➤ ndjek strukturat e dhëna për të shkruar një tregim ku përshkruan ngjarje reale ose të imagjinuara; ➤ përdor burime të ndryshme për të shkruar një tregim të thjeshtë mbi temat e tij të interesit; ➤ harton projekte dhe prezanton ato duke përdorur njohuritë në TIK.	➤ modelon mesazhe që kanë të bëjnë me pyetje të ndryshme dhe shpjegim problemesh; ➤ përmbledh artikuj të ndryshëm gazetash me tema të fushës së tij të interesit; ➤ formulon një raport duke përdorur burime të ndryshme informacioni dhe jep mendimin e tij personal; ➤ harton një ese të thjeshtë mbi temat e tij të interesit; ➤ harton projekte sintetizuese mbi temat e tij të interesit dhe përdor njohuritë në TIK.
Kompetenca IV: Përdorimi i drejtë i gjuhës		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi kupton, shqipton dhe komunikon me korrektesë të mjaftueshme mesazhin (me shkrim dhe me gojë) nëpërmjet strukturave të sakta gramatikore, sipas rregullave të përgjithshme. Përdor mjaftueshëm mirë një repertor të shprehive dhe frazave që bashkëngjiten me situata pothuajse të paparashikuara për të.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ demonstroi të kuptuarin e rregullave bazë të gramatikës; ➤ përsërit sipas modeleve të dhëna format e ndryshme gramatikore	Nxënësi: ➤ ndërton fjali, paragrafë, tregime të thjeshta pa gabime gramatikore duke u bazuar mbi një model të dhënë;	Nxënësi: ➤ kombinon fjali të thjeshta dhe të përbëra në paragrafë dhe tregime me gojë dhe me shkrim pa bërë gabime gramatikore;



5 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “MATEMATIKË”

SHKALLA V		
Kompetenca I: Zgjidhja problemore		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përshkruan dhe zgjidh situata problemore, të nivelit praktik të marra nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme dhe të nivelit abstrakt duke zhvilluar kapacitetin e tij intelektual dhe intuitën krijuese.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ <i>kupton</i> situata problemore, të thjeshta, me ndihmën ose jo të teknologjisë; ➤ <i>njeh</i> marrëdhëniet ndërmjet bashkësive; ➤ <i>përcakton pjesërisht</i>, teknikën e përshtatshme për zgjidhjen e problemave të thjeshta; ➤ <i>identifikon</i> simbolet trigonometrike dhe gjeometrike për të përshkruar situata praktike; ➤ <i>kupton</i> tabela dhe diagrame të gatshme.	Nxënësi: ➤ <i>interpret</i>on situata problemore, jo të ndërlikuara, me ndihmën ose jo të teknologjisë; ➤ <i>identifikon</i> marrëdhëniet ndërmjet bashkësive; ➤ <i>zbaton</i> strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemave të simuluar nga jeta reale dhe me shembuj nga shkencat e tjera; ➤ <i>përdor pjesërisht</i> simbolet trigonometrike dhe gjeometrike për të përshkruar situata praktike; ➤ <i>lexon</i> tabela dhe diagrame të gatshme.	Nxënësi: ➤ <i>modelon dhe zgjidh</i> situata problemore, jo të ndërlikuara, me ndihmën ose jo të teknologjisë; ➤ <i>demonstron</i> marrëdhëniet ndërmjet bashkësive; ➤ <i>përzgjedh dhe zbaton</i> strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemave të simuluar nga jeta reale dhe me shembuj nga shkencat e tjera; ➤ <i>përdor</i> simbolet trigonometrike dhe gjeometrike për të përshkruar situata praktike; ➤ <i>kryen vrojtme dhe interpretime</i> të tabelave dhe diagrameve të gatshme.
Kompetenca II: Arsyetimi, vërtetimi matematik dhe të menduarit e komunikimi matematik		



Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përdor arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës duke organizuar në mënyrë logjike faktet, idetë ose konceptet në mënyrë që të arrijë në një rezultat më të besueshëm se intuita. Ai përdor komunikimin nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik duke kuptuar se kjo gjuhë përdoret jo vetëm në lëndë të tjera, por edhe në jetën e përditshme.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ <i>njeh dhe përdor pjesërisht</i> simbole dhe formula trigonometrike, gjeometrike, algjebrike, statistikore për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme; ➤ <i>interpret</i> teorema të ndryshme; ➤ <i>komunikon</i> të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit) duke përdorur gjuhën e përditshme, fjalorin matematik; ➤ <i>dallon</i> informacionin e dhënë nga figura gjeometrike të thjeshta dy dimensionale në tredimensionale, grafikë, tabela, diagrame.	Nxënësi: ➤ <i>përdor</i> simbole dhe formula trigonometrike, gjeometrike, algjebrike, statistikore për të përshkruar situata të ndryshme nga matematika dhe nga jeta e përditshme; ➤ <i>përdor</i> parashikimin për të gjykuar zgjidhjen e një problemi trigonometrik dhe gjeometrik brenda njohurive të mësuara; ➤ <i>vërteton pjesërisht</i> teorema, me silogjizëm dhe nga e kundërta; ➤ <i>njeh</i> rregulla elementare të logjikës e të arsyetimit korrekt; ➤ <i>komunikon</i> të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur gjuhën e përditshme, fjalorin matematik, paraqitje të ndryshme; ➤ <i>kupton</i> informacionin e dhënë nga figura	Nxënësi: ➤ <i>gjykon</i> vërtetësinë e një rezultati të dhënë, i cili mund të jetë gjetur me llogaritje, me zbatimin e formulave të njohura ose me përdorimin e teknologjisë; ➤ <i>sugjeron</i> formula të ndryshme; ➤ <i>përdor arsyetimin</i>, veprimet me mend ose parashikimin për zgjidhjen e një problemi trigonometrik, gjeometrik, algjebrik, statistikor brenda njohurive të mësuara. ➤ <i>vërteton</i> teorema, me silogjizëm dhe nga e kundërta; ➤ <i>përdor</i> kundërshebullin për të argumentuar rezultatin; ➤ <i>përdor</i> rregulla elementare të logjikës e të arsyetimit korrekt; ➤ <i>komunikon</i> të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit) duke përdorur gjuhën e përditshme, fjalorin matematik, paraqitje të ndryshme;



	gjeometrike të thjeshta dy dimensionale në tredimensionale, grafikë, tabela, diagrame.	➤ <i>shkëmben</i> informacion nga figura gjeometrike të thjeshta dy dimensionale në tredimensionale, grafikë, tabela, diagrame.
Kompetenca III: Modelimi matematik dhe lidhja konceptuale		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përshkruan dhe krijon modele duke përdorur veprimet themelore matematikore në situata të jetës së përditshme. Ai modelon situata nga jeta reale me gjuhën matematikore duke përdorur koncepte matematike për të formuar një të tërë si dhe kupton varësitë ndërmjet këtyre koncepteve.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ <i>kupton</i> modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore, si: numër dhjetor, thyesë, përqindje, eksponent, kënde, kongruencë, formula trigonometrike, shndërrime gjeometrike, tigonometri e trekëndëshit, vektorë, ndryshor, ekuacion, sistem, funksion, varg, probabilitet etj; ➤ <i>liston</i> konceptet matematikore lidhur me numrat në situata financiare dhe sipërmarrëse; ➤ <i>bën pjesërisht lidhjen</i> ndërmjet koncepteve matematikore;	Nxënësi: ➤ <i>zbaton</i> modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore, si: numër dhjetor, thyesë, përqindje, eksponent, kënde, kongruencë, formula trigonometrike, shndërrime gjeometrike, trigonometri e trekëndëshit, vektorë, ndryshor, ekuacion, sistem, funksion, varg, probabilitet etj; ➤ <i>interpretton</i> konceptet matematikore lidhur me numrat në situata financiare dhe sipërmarrëse; ➤ <i>kupton</i> figurat simbolike përmes vijave dhe grafikëve, për përshkrimin dhe zgjidhjen e problemeve të thjeshta në matematikë dhe në jetën e përditshme.	Nxënësi: ➤ <i>krijon</i> modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore, si: numër dhjetor, thyesë, përqindje, eksponent, kënde kongruencë, formula trigonometrike, shndërrime gjeometrike, tigonometri e trekëndëshit, vektorë, ndryshor, ekuacion, sistem, funksion, varg, probabilitet etj; ➤ <i>modelon</i> konceptet matematikore lidhur me numrat në situata financiare dhe sipërmarrëse; ➤ <i>përdor</i> shkathtësi argumentuese lidhur me modelimin dhe me zbatimin e formulave; ➤ <i>përdor</i> figurat simbolike përmes vijave dhe grafikëve, për përshkrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në matematikë, në fushat e tjera dhe në jetën e përditshme.



➤ <i>dallon</i> njohuritë matematikore të zbatuara në situata ose dukuri të marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.);	➤ <i>bën lidhjen</i> ndërmjet koncepteve matematikore; ➤ <i>zbaton</i> njohuritë matematikore në situata ose dukuri të marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).	➤ <i>integron</i> njohuritë, shprehitë dhe procedurat matematikore në situata ose dukuri të marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.).
Kompetenca IV: Përdorimi i teknologjisë në matematikë		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përdor teknologjinë si mjet për të zgjidhur apo verifikuar zgjidhjet si dhe për të mbledhur, komunikuar e zbuluar informacione.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ <i>njih dhe kupton përdorimin e</i> pajisjeve të inputit, outputit, si: usb, cd, dvd, printer; ➤ <i>njih</i> programet Word, Excel për të shkruar tekste, figura, tabela, grafikë; ➤ <i>përdor pjesërisht</i> teknologjinë për zbatime të matematikës në situata të thjeshta praktike.	Nxënësi: ➤ <i>përdor pjesërisht</i> pajisjet e inputit, outputit, si: usb, cd, dvd, printer; ➤ <i>përdor pjesërisht</i> programet Word, Excel për të shkruar tekste, figura, tabela, grafikë; ➤ <i>kupton</i> detyra matematikore të zgjidhura nëpërmjet teknologjisë dhe TIK-ut; ➤ <i>përdor pjesërisht</i> teknologjinë për zbatime të matematikës në situata të njohura praktike.	Nxënësi: ➤ <i>përdor</i> pajisjet e inputit, outputit, si: usb, cd, dvd, printer; ➤ <i>përdor</i> programet Word, Excel për të shkruar tekste, figura, tabela, grafikë; ➤ <i>zgjidh</i> detyra matematikore duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e teknologjisë dhe të TIK-ut; ➤ <i>përdor</i> teknologjinë për të analizuar, komunikuar dhe zbuluar informacion matematikor; ➤ <i>përdor</i> teknologjinë për zbatime të matematikës në shkencat e tjera.





6 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “SHKENCAT E NATYRËS”

6.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “FIZIKË”

SHKALLA V		
Kompetenca I: Kërkimi i përgjigjeve ose i zgjidhjeve të problemeve shkencore		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi identifikon karakteristikat shkencore të problemit, thekson elementet që kanë lidhje me njeri-tjetrin dhe e formulon problemin. Ai merr parasysh strategji të ndryshme, kufizimet që shoqërojnë secilën prej tyre, zgjedh atë që mendon se është më e mira, argumenton zgjedhjen e bërë dhe planifikon procedurën. Nxënësi kërkon trendët domethënës në të dhënat ose provat tipike, kontrollon rezultatet sipas procedurës, formulon probleme të reja ose sugjeron mënyrat e përmirësimit të zgjidhjes dhe nxjerr rezultatet. Ai ndjek hapat e planit dhe nëse është e nevojshme, përshtat testet e tij, e rishikon planin ose kërkon një mënyrë të re për zgjidhjen e problemit. Ai mban shënim për çdo detaj ose vërtetim të nevojshëm për analizën e problemit.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ➤ identifikon pak elementë që lidhen pak a shumë me zgjidhjen e tij; ➤ propozon një plan veprimi për të identifikuar ndryshoret, që janë disi të rëndësishme;	Nxënësi : ➤ identifikon disa elemente që lidhen me zgjidhjen e tij; ➤ formulon pyetje, shpjegon ose ngre hipoteza, që lidhen me disa koncepte, që lidhen me problemin;	Nxënësi : ➤ ofron një zgjidhje të qartë dhe të plotë të tij; ➤ formulon pyetje, shpjegon ose ngre një hipotezë, që mbështetet nga konceptet e përshtatshme;



➤ përshkruan disa nga hapat që kryhen ose disa mënyra të zgjidhjes pa kontrolluar, nëse ato janë të lidhura me rezultatet e zgjidhjes së problemit; ➤ identifikon madhësitë fizike në formula; ➤ përkufizon madhësitë fizike skalare nga ato vektoriale; ➤ përshkruan me pak gabime konceptet, idetë, parimet, ligjet e fizikës; ➤ identifikon konceptet fizike, duke i interpretuar me shembuj të thjeshtë nga teksti; ➤ shkruan formulat që shprehin ligjet e fizikës dhe identifikon madhësitë fizike nga të cilat varen; ➤ shpjegon pak nga karakteristikat e një madhësie fizike; ➤ përshkruan ndërtimin e pajisjeve teknologjike; ➤ përcakton disa nga pjesët kryesore të pajisjeve teknologjike; ➤ bën një përshkrim të shkurtër të modeleve në fizikë;	➤ propozon një plan veprimi që identifikon madhësitë fizike që përcaktojnë zgjidhjen; ➤ tregon kujdes gjatë punës në laborator për veten dhe për të tjerët; ➤ propozon zgjidhje që reflektojnë në përgjithësi rezultatet e tij / saj; ➤ përdor formulat matematikore në zbatimin e ligjeve, por bën gabime të vogla (p.sh. në konvertimin e njësive matëse); ➤ përshkruan me pak gabime konceptet e fizikës dhe i interpreton me shembuj të ngjashëm me ato të tekstit; ➤ shpjegon me pak gabime dukuritë dhe ligjet e fizikës, duke i interpretuar me shembuj nga teksti; ➤ shpjegon ndikimin e ligjeve të fizikës në jetën e përditshme, duke përdorur shembuj të ngjashëm nga ato të tekstit; ➤ bën dallimin, ndryshimin ndërmjet madhësive fizike; ➤ përkufizon me pak gabime ligjet e ruajtjes për një trup, kur mbi të nuk veprojnë forcat e jashtme dhe i ilustron me shembuj;	➤ propozon një plan të qartë veprimi dhe përcakton rezultatet e zgjidhjeve; ➤ justifikon ndryshimet që duhen bërë për planin e tij/ e saj, bazuar në rezultatet e marra; ➤ zgjedh informacionin përkatës që lidhet me problemin që zgjidhet; ➤ planifikon hapat për plan- veprimin e tij / saj , për të përcaktuar madhësitë fizike që përcaktojnë zgjidhjen; ➤ analizon të dhënat e duhura duke përdorur saktë njësitë matëse; ➤ përcakton me efikasitet gabimet në matje gjatë matjes së madhësive fizike; ➤ krahason rezultatet e tij / saj me vlerat teorike, nëse është e nevojshme; ➤ kontrollon, nëse përputhen rezultatet me hipotezën; ➤ vlerëson përgjigjet apo zgjidhjet e ushtrimeve; ➤ kryen veprimet matematikore duke u bazuar në arësytetime logjike; ➤ propozon ide të reja për përmirësimin e metodologjisë së përdorur për zgjidhje, kur e shikon atë arësyeshme;
---	---	--



➤ shpjegon lidhjen ndërmjet madhësive fizike në formulë; ➤ përshkruan disa nga zbatimet e ligjeve të fizikës në teknologji.	➤ zbaton duke bërë gabime të vogla formulat e ligjeve të fizikës, duke i interpretuar me shembuj të thjeshtë nga teksti; ➤ liston vetitë fizike të trupave, duke i interpretuar me shembuj konkretë; ➤ jep shembuj si i shfrytëzon njeriu ligjet e fizikës për nevojat e jetës së përditshme; ➤ shpjegon përgjithësisht mirë parimet bazë të fizikës; ➤ shpjegon në përgjithësi karakteristikat e pajisjeve teknologjike; ➤ llogarit madhësitë fizike gjatë zbatimit të ligjeve të fizikës në raste të thjeshta ose shembuj nga teksti; ➤ ndërton me pak gabime grafikët që shprehin ligjet e fizikës; ➤ ndërton me pak gabime figurat për konkretizimin e ligjeve dhe dukurive të fizikës; ➤ demonstroi pjesërisht dukuritë dhe ligjet e fizikës; ➤ shpjegon përdorimet e ligjeve, duke i konkretizuar me shembuj nga teksti;	➤ argumenton madhësitë fizike pse quhen skalare apo vektoriale; ➤ përcakton me lehtësi madhësitë fizike; ➤ analizon konceptet, idetë, parimet, ligjet e fizikës, duke i ilustruar me shembuj nga situata të jetës reale; ➤ vlerëson rolin e ligjeve të fizikës në ndërtimin e pajisjeve teknologjike; ➤ përcakton saktë madhësitë fizike; ➤ argumenton me efikasitet si e shfrytëzon njeriu ligjet e fizikës në situata reale; ➤ analizon ndryshimin e madhësive fizike dhe tregon faktorët që ndikojnë për ndryshimin e saj; ➤ argumenton vetive fizike të trupave; ➤ analizon parimet bazë të fizikës; ➤ shpjegon saktë të gjithë karakteristikat e sistemeve në fizikë; ➤ analizon variablat në grafikët e ligjeve të fizikës; ➤ analizon lidhjen mes madhësive fizike; ➤ përdor me lehtësi simulimet përmes TIK-ut për të demonstruar dukuritë dhe ligjet e fizikës;
--	---	--



	➤ shpjegon përgjithësisht mirë pjesët kryesore të pajisjeve teknologjike, dhe shpjegon si funksionojnë ato; ➤ shpjegon përgjithësisht mirë modelet në fizikë; ➤ përshkruan raste të thjeshta të zbatimit të ligjeve të fizikës në fushën e mjekësisë; ➤ përshkruan pjesërisht rëndësinë e përdorimit të ligjeve të fizikës në ndërtimin e pajisjeve teknologjike.	➤ shpjegon me efikasitet modelet që përdoren në fizikë; ➤ interpreton zbatimin e ligjeve të fizikës në fushën e mjekësisë; ➤ analizon rëndësinë e përdorimit të ligjeve të fizikës në ndërtimin e pajisjeve teknologjike.
SHKALLA V		
Kompetenca II: Përdorimi i njohurive shkencore dhe teknologjike		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi studion ndikimet afatgjata të shkencës dhe të teknologjisë tek individët, shoqëria, mjedisi dhe ekonomia. Ai vendos shkencën dhe teknologjinë në kontekstet e tyre sociale dhe historike, si dhe studion ndikimin e tyre në mënyrën e jetesës së njerëzve. Nxënësi identifikon pyetje ose çështje etike. Ai kupton si funksionojnë objektet teknike, tregon kuriozitet për to, shqyrton përbërjen dhe funksionimin e tyre dhe nëse është e nevojshme i zbërthen në pjesë, identifikon materialet, pjesët dhe tipat e ndryshëm të lidhjeve në objektet teknike, dallon sisteme dhe nënsisteme të ndryshme dhe shpjegon si funksionojnë ato. Nxënësi kupton dukuritë natyrore, pyet veten rreth mjedisit të tij, shqyrton dukuri të veçanta dhe përshkruan karakteristikat e tyre, i ilustron ato me diagrama skematike, shpjegon dukuritë duke përdorur ligjet ose modelet dhe siguron koherencën e shpjegimit. Ai familjarizohet me konceptet që lidhen me dukuritë dhe pranon lidhjen e tyre.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: ➤ formulon pyetje, që kryesisht lidhen në elemente dytësore; ➤ propozon ide, të pabazuar në logjikë; ➤ përshkruan shkurtimisht konceptet kryesore; ➤ realizon vetëm fillimin e një shpjegimi shkencor; ➤ tregohet disi i kujdesshëm gjatë përdorimit të pajisjeve laboratorike; ➤ ndërton me vështirësi diagrama të thjeshta për të prezantuar madhësitë fizike, dukuritë, ligjet, parimet e fizikës; ➤ përdor sipas udhëzimeve të mësuesit pajisjet për të demonstruar parimet, dukuritë dhe ligjet e fizikës; ➤ përdor në disa raste kompjuterin, për ndërtimin e grafikëve dhe kryerjen e procedurave statistikore, mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e të dhënave;	Nxënësi : ➤ formulon pyetje, që lidhen me dukuritë; ➤ zbaton në mënyrë korrekte disa koncepte; ➤ përdor formalisht konceptet matematikore, por bën gabime të vogla në procesin (p.sh. gjatë konvertimit të njësive matëse, apo ndërtimin e figurave; ➤ realizon shpjegime të pjesshme, që lidhen me dukurinë dhe zbatimin e saj; ➤ tregohet relativisht i kujdesshëm në përdorimin e pajisjeve laboratorike; ➤ ndërton me pak gabime diagramat kryesore për të prezantuar madhësitë fizike, dukuritë, ligjet, parimet e fizikës; ➤ përdor në përgjithësi mirë pajisjet për të demonstruar parimet, dukuritë dhe ligjet kryesore të fizikës; ➤ përdor përgjithësisht me lehtësi kompjuterin, për ndërtimin e	Nxënësi: ➤ formulon pyetje, që përcaktojnë aspektet thelbësore të dukurive; ➤ demonstroi aftësitë e tij/saj për të zbatuar konceptet e duhura; ➤ kryen shpjegime koherente dhe të plota, bazuar në parimet bazë të fizikës; ➤ përdor saktë aparatin matematikor për zgjidhjen e ushtrimeve dhe problemave të fizikës; ➤ argumenton ndikimin e ligjeve apo dukurive dhe zbatimin e tyre në situata të jetës së përditshme; ➤ bën vlerësimet e duhura kur përdor vlerëson konceptet, ligjet, teoritë dhe modelet e fizikës; ➤ vlerëson teoritë e shkencëtarëve, duke argumentuar si kanë evoluar teoritë e tyre nga njëra epokë në tjetrën; ➤ tregon siguri të lartë në përdorimin e pajisjeve laboratorike; ➤ ndërton me lehtësi saktë të gjitha diagramat për të prezantuar
--	---	---



➤ përcakton pjesërisht njësitë matëse të madhësive fizike; ➤ emërton disa nga madhësitë fizike që përdoren për ndërtimin e hartës së koncepteve; ➤ përdor pjesërisht simulimet për të demonstruar dukuritë, proceset, ligjet e fizikës.	grafikëve dhe kryerjen e procedurave statistikore, mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e të dhënave; ➤ përdor mirë njësitë matëse të madhësive fizike duke bërë gabime të vogla gjatë zgjidhjes së ushtrimeve; ➤ ndërton me ndihmën e mësuesit hartën e koncepteve për një tematikë të caktuar; ➤ përdor përgjithësisht mirë simulimet për të demonstruar përmes tyre dukuritë, proceset dhe ligjet e fizikës.	madhësitë fizike, dukuritë, ligjet, parimet e fizikës; ➤ përdor me efikasitet të lartë pajisjet e duhura për të demonstruar parimet, dukuritë dhe ligjet e fizikës; ➤ përdor lehtësisht kompjuterin, për ndërtimin e grafikëve dhe kryerjen e procedurave statistikore, mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e të dhënave; ➤ përdor saktë njësitë matëse të madhësive fizike gjatë zgjidhjes së ushtrimeve; ➤ argumenton hartën e koncepteve për një tematikë të caktuar; ➤ përdor lehtësisht simulimet për të demonstruar dukuritë, proceset dhe ligjet e fizikës.
---	---	---

SHKALLA V

Kompetenca III : Komunikimi me gjuhën shkencore dhe teknologjike

Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi shkëmben informacione shkencore me të tjerët. Ai kupton rolin e ndarjes së informacionit dhe është i hapur në këndvështrimet e të tjerëve, krahason të dhënat dhe procedurat e tij me ato të të tjerëve dhe vlerëson këndvështrimin ose zgjidhjen e tij duke i krahasuar me ato të të tjerëve. Nxënësi përhap dhe zhvillon njohuritë ose rezultatet shkencore. Ai merr parasysh përbërjen e audiencës, përdor



mënyra të ndryshme për prezantimin e informacionit (p.sh., simbolet, tabelat, vizatimet teknike) dhe përshtat mesazhin sipas tipit të medias që përdor (p.sh. prezantim me gojë ose me shkrim etj.). Nxënësi interpreton dhe formulon mesazhe shkencore. Ai përdor informacionin shkencor dhe teknologjik të marrë nga burime të ndryshme duke u siguruar që burimet të jenë të besueshme dhe të përshtatshme. Ai prezanton informacionin sipas rregullave dhe konvencioneve të shkencës, teknologjisë dhe matematikës.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ formulon shkurt një mesazh, pa dhënë shpjegimet e duhura; ➤ përdor një fjalor bazë për të shpjeguar konceptet, idetë, teoritë parimet, ligjet e fizikës me një terminologji, e cila në pjesën më të madhe nuk është në përputhje me rregullat dhe marrëveshjet; ➤ identifikon me pak gabime madhësitë fizike të vendosura në tabela, diagrame dhe grafikë; ➤ përkufizon me pak gabime koncepte, ide, teori, parime, ligje, procedura dhe procese fizike; ➤ përdor pjesërisht mirë një terminologji të thjeshtë për të shprehur simbolikisht madhësitë	Nxënësi: ➤ përzgjedh disa informacione për të shpjeguar mesazhin; ➤ përdor burime informacioni që mund të mos jenë krejtësisht të përshtatshme; ➤ shpjegon teoritë pa cënuar të drejtat e pronësisë intelektuale; ➤ përdor terminologjinë e duhur në përputhje me rregullat dhe marrëveshjet kur shpjegon koncepte të thjeshta; ➤ përdor një terminologji të thjeshtë për interpretimin e diagramave, tabelave dhe grafikëve; ➤ shpjegon përgjithësisht mirë madhësitë fizike të vendosura në tabela, diagrame dhe grafikë; ➤ shpjegon përgjithësisht mirë koncepte, ide, teori, parime, ligje,	Nxënësi : ➤ interpreton saktësisht informacionet që jep një mesazh; ➤ përdor gjuhën dhe terminologjinë e duhur për të shpjeguar me lehtësi konceptet, idetë, teoritë parimet, ligjet e fizikës, dhe njëkohësisht për ti interpretuar zbatimet e tyre në kontekstin e situatave të jetës së përditshme; ➤ përzgjedh dhe përdor burime të ndryshme dhe të besueshme të informacionit; ➤ përdor saktë terminologjinë e duhur, kur interpreton diagramat, tabelat dhe grafikët; ➤ interpreton me efikasitet madhësitë fizike të vendosura në tabela, diagrame dhe grafikë;



fizike, formulat, njësitë matëse të sistemit SI.	procedura dhe procese fizike, duke i ilustruar ato me shembuj nga teksti; ➤ përdor përgjithësisht mirë terminologjinë e duhur për të shprehur simbolikisht madhësitë fizike, formulat, njësitë matëse të sistemit SI.	➤ përdor me lehtësi terminologjinë e duhur për të shprehur simbolikisht madhësitë fizike, formulat, njësitë matëse të sistemit SI.
--	---	---

6.2 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “BIOLOGJI”

SHKALLA V		
Kompetenca I: Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve në biologji		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi identifikon karakteristikat shkencore të problemit, thekson elementet që kanë lidhje me njeri-tjetrin dhe e formulon problemin. Ai përdor konceptet që lidhen me problemin të tilla si ato: gjenetike, bioteknologjike, mjedisore, sistemet e organeve të bimët dhe njeriu dhe biologjisë qelizore. Nxënësi i trajton konceptet sa më shpesh të jetë e mundur me metodën sasiore duke marrë në konsideratë gabimet e lidhura me matjet. Ai kërkon për burime shtesë për të zgjidhur problemin, justifikon zgjedhjen e metodave, strategji apo teknikave. Nxënësi demonstroi rigorozitet në zbatimin e procedurave dhe kontrollon variablat pa marrë udhëzime. Ai zhvillon qëndrime lidhur me efektivitetin dhe efikasitetin kur reflekton vetëm ose në grupe.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ <i>bën supozime që lidhen pak a shumë me problemin bioteknologjik, gjenetik, shëndetsor që do të zgjidhet;</i>	Nxënësi: ➤ <i>identifikon elementet e problemit që duhet zgjidhur ose kërkesat që duhet të plotësohen;</i>	Nxënësi: ➤ <i>përshkruan në mënyrë të qartë dhe të plotë problemin që do të zgjidhet ose kërkesat që duhet të plotësohen;</i>



➤ <i>propozon një plan jo të plotë të veprimit duke identifikuar variabla që janë me pak ose pa asnjë rëndësi;</i> ➤ <i>përshkruan disa nga hapat e kryer ose disa aspekte të zgjidhjes;</i> ➤ <i>paraqet rezultatet dhe propozon përgjigje ose zgjidhje pa kontrolluar nëse ato janë të lidhura me problemin apo me rezultatin.</i>	➤ <i>formulon hipoteza apo zgjidhje të mundshme që marrin në konsideratë disa nga kufizimet që lidhen me këtë problem;</i> ➤ <i>propozon një plan bazë veprimi që identifikon variablat që mund të ndikojnë në rezultat;</i> ➤ <i>punon në një mënyrë që tregon shqetësim për sigurinë e vet dhe të njerëzve të tjerë;</i> ➤ <i>paraqet disa nga informacionet e mbledhura dhe ndjek hapat e planifikuar për kryerjen e veprimtarisë;</i> ➤ <i>në një veprimtari shkencore, bën lidhjet midis hipotezës dhe analizës së tij të rezultateve;</i> ➤ <i>në një veprimtari teknologjike, propozon një zgjidhje në lidhje me hulumtimet e tij që plotëson pjesërisht nevojën e identifikuar ose specifikimet;</i> ➤ <i>propozon përgjigje apo zgjidhje që në përgjithësi pasqyrojnë rezultatet ose provat e tij.</i>	➤ <i>formulon hipoteza apo zgjidhje të mundshme që mbështeten në konceptet e duhura;</i> ➤ <i>gjatë zhvillimit të një plani veprimi, parashikon kontrollin e variablave që ndikojnë në rezultat;</i> ➤ <i>propozon një plan efikas të veprimit;</i> ➤ <i>propozon përgjigje ose zgjidhje të plotë të problemit;</i> ➤ <i>argumenton ndryshimet që duhet të bëhen për planin e tij të veprimit mbi bazën e rezultateve të marra.</i>
Kompetenca II: Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore në biologji		
Përshkrimi i kompetencës:		



Nxënësi studion ndikimet afatgjata të shkencës dhe të teknologjisë tek individët, shoqëria, mjedisi dhe ekonomia. Ai vendos shkencën dhe teknologjinë në kontekstet e tyre sociale dhe historike, si dhe studion ndikimin e tyre në mënyrën e jetesës së njerëzve. Nxënësi identifikon pyetje ose çështje etike që lidhen me klonimin, diseksionin e kafshëve, abortin etj.. Ai kupton si funksionojnë objektet teknike, tregon kuriozitet për to, shqyrton përbërjen dhe funksionimin e tyre dhe, nëse është e nevojshme, i zbërthen në pjesë, identifikon materialet, pjesët dhe tipat e ndryshëm të lidhjeve në objektet teknike, dallon sisteme dhe nënsisteme të ndryshme dhe shpjegon si funksionojnë ato. Nxënësi kupton dukuritë natyrore, pyet veten rreth mjedisit të tij, familjarizohet me konceptet që lidhen me dukuritë dhe pranon lidhjen e tyre. Ai përdor njohuritë biologjike për shpjegimin e dukurive ose zbatimin e koncepteve biologjike duke përdorur metodën e vëzhgimit, metodën eksperimentale si dhe modelimin. Nxënësi përdor aparatin matematikor për të mbështetur arsyetimin e tij dhe argumenton shpjegimet duke përdorur diagrama skematike.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ formulon pyetje që fokusohen kryesisht në elemente dytësore të një çështjeje ose procesi bioteknologjik, mjedisor, shnëndetsor ; ➤ propozon një shpjegim, zgjidhje apo mendim që është i pabazuar; ➤ përmend konceptet që lidhen me këtë çështje; ➤ emërton disa nga parimet e funksionimit të një objekt teknik, një sistemi teknologjik apo një produkti; ➤ jep vetëm fillimet e një shpjegimi apo zgjidhjeje.	Nxënësi: ➤ formulon pyetje ose ofron një shpjegim paraprak, zgjidhje apo mendim duke përcaktuar disa nga aspektet thelbësore të çështjes ose procesit; ➤ përcakton funksionimin e përgjithshëm të një objekti teknik, një sistemi teknologjik apo një produkti; ➤ zbaton me korrektësi disa koncepte të kërkuara; ➤ ofron një përshkrim të shkurtër të parimeve të funksionimit të objektit teknik ose sistemit teknologjik; ➤ përdor aparatin matematikor, por bën gabime të vogla në proces;	Nxënësi: ➤ propozon zgjidhje ose jep shpjegimin e tij duke zbatuar parimet e njohura shkencore ose teknologjike; ➤ tregon se zotëron aftësinë për të zbatuar konceptet; ➤ sugjeron përmirësime që kanë të bëjnë me zgjedhjen e materialeve apo proceseve prodhuese të lidhur me objektin teknik apo teknologjik të sistemit; ➤ jep shpjegime, justifikon zgjidhjet e tij ose mbron mendimet e veta duke respektuar parimet themelore shkencore ose teknologjike;



	➤ jep shpjegime të pjesshme ose propozon zgjidhje lidhur me këtë çështje; ➤ identifikon pasojat dytësore që kanë të bëjnë me çështjen e shqyrtuar.	➤ pasuron shpjegimet e tij duke përdorur aparatën matematikor; ➤ identifikon pasojat pozitive dhe negative në lidhje me çështjen e shqyrtuar.
Kompetenca III: Komunikimi i ideve biologjike duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi shkëmben informacione shkencore me të tjerët. Ai kupton rolin e ndarjes së informacionit dhe është i hapur në këndvështrimet e të tjerëve, krahason të dhënat dhe procedurat e tij me ato të të tjerëve dhe vlerëson këndvështrimin ose zgjidhjen e tij duke i krahasuar me ato të të tjerëve. Nxënësi përhap dhe zhvillon njohuritë ose rezultatet shkencore. Ai prezanton idetë që lidhen me konceptet të përgjithshme biologjike si: mjedisore, gjenetike, qelizore, shëndetsore, bioteknologjike. Ai merr parasysh përbërjen e audiencës, përdor mënyra të ndryshme për prezantimin e informacionit (p.sh., simbolet, tabelat, vizatimet teknike) dhe përshtat mesazhin sipas tipit të medias që përdor (p.sh. prezantim me gojë ose me shkrim etj.). Nxënësi interpreton dhe formulon mesazhe shkencore. Ai përdor informacionin biologjik dhe teknologjik të marrë nga burime të ndryshme duke u siguruar që burimet të jenë të besueshme dhe të përshtatshme. Ai prezanton informacionin sipas rregullave dhe konvencioneve të shkencës, teknologjisë dhe matematikës.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ jep një mesazh duke paraqitur elementet e tij, pa ia përshtatur atë audiencës së synuar; ➤ përdor fjalorin bazë ose mjetet e prezantimit që janë në masë të madhe në kundërshtim me rregullat dhe konvencionet.	Nxënësi: ➤ përzgjedh disa informacione në mesazh; ➤ përdor burime informacioni që mund të ndryshojnë besueshmërinë e tyre; ➤ organizon dhe përshtat pjesërisht elementet e mesazhit të tij; ➤ prodhon një mesazh pa shkelur të drejtat e pronësisë intelektuale;	Nxënësi: ➤ përdor elemente plotësuese për të rritur cilësinë e komunikimit; ➤ interpreton me saktësi informacionin në mesazh; ➤ përdor gjuhën dhe terminologjinë e duhur për ta bërë mesazhin e tij më të lehtë për t'u kuptuar dhe interpretuar;



	➤ për koncepte më të thjeshta, përdor terminologji në përputhje me rregullat dhe marrëveshjet; ➤ përzgjedh dhe përdor mjete të pranueshme të prezantimit për të shfaqur të dhënat.	➤ përzgjedh dhe përdor mjete të përshtatshme për prezantim; ➤ organizon informacionin e mbledhur në mënyra që ta bëjnë më të lehtë për tu përpunuar apo interpretuar.
--	---	--

6.3 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “KIMI”

SHKALLA V		
Kompetenca I: “Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve kimike”		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi identifikon karakteristikat shkencore të problemit, thekson elementet që kanë lidhje me njeri-tjetrin dhe e formulon problemin. Ai demonstroi aftësitë e tij për kërkimin e përgjigjeve ose zgjidhjen e problemeve kryesore të kimisë si dhe zbatimin e metodologjisë së duhur për zgjidhjen e problemeve praktike. Ai pranon për trajtimin e zgjidhjes së problemeve, në pjesën më të madhe metodën eksperimentale, metodën e modelimit dhe vëzhgimit dhe në disa raste, metodën empirike. Nxënësi harton idetë që lidhen me konceptet e përgjithshme: mbi teorinë e grimcave të lëndës, teorinë mbi ndërtimin e atomit, ndryshimet e energjisë në reaksione, shpejtësinë e reaksionit dhe ekuilibrin kimik, shkrimin dhe zbatimin e formulave të njohura. Ai përdor metodat, strategjitë apo teknikat e duhura, në lidhje me konceptet në analizën cilësore dhe sasiore, sipas kontekstit si dhe përdorimin e aparatit matematikor për të mbështetur arsyetimin e tij.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ➤ bën supozime të cilat lidhen pak a	Nxënësi : ➤ identifikon elementet e problemit	Nxënësi : ➤ përshkruan në mënyrë të qartë dhe



Kompetenca II: “ Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore në kimi” Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi merr dhe përdor njohuritë kimike për shpjegimin e dukurive ose zbatimin e koncepteve kimike duke përdorur metodën e vëzhgimit , metodën eksperimentale si dhe modelimin. Ai përdor strategji të ndryshme për të zgjidhur problemet (p.sh zgjidhjen e
--

problemeve qasje, raste studimore, debat,projekti i bazuar në qasje). Nxënësi paraqet një qëndrim reflektues, analizon të dhënat dhe informacionin në mënyrë që të zhvillojë aftësitë e tij njohëse në situata gjithnjë e më të ndërlikuara. Nxënësi identifikon elementet shkencore (konceptet, ligjet, modele, teoritë, parimet) të problemit. Ai harton idetë që lidhen me konceptet e përgjithshme: mbi teorinë e grimcave të lëndës, teoritë mbi ndërtimin e atomit, ndryshimet e energjisë në reaksione , shpejtësinë e reaksionit dhe ekuilibrin kimik, shkrimin dhe zbatimin e formulave të njohura. Ai përdor metodat, strategjitë apo teknikat e duhura, në lidhje me konceptet e analizës cilësore dhe sasiore, sipas kontekstit si dhe përdorimin e aparatit matematikor për të mbështetur arsyetimin e tij, argumenton shpjegimet e tij duke përdorur figura të rëndësishme.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ➤ <i>formulon pyetje</i> që fokusohen kryesisht në <i>elemente dytësore</i>; ➤ <i>propozon</i> një shpjegim paraprak që <i>është i pabazuar</i>; ➤ <i>përmend konceptet</i> bazë kimike që lidhen me fenomenin apo zbatimin e tij; ➤ <i>jep vetëm</i> fillimet e një shpjegimi shkencor.	Nxënësi : ➤ <i>formulon</i> pyetje ose jep shpjegime paraprake, <i>përcakton disa</i> aspekte thelbësore të fenomenit apo zbatimit të tij; ➤ <i>zbaton drejt disa</i> koncepte bazë kimike në mënyrën e duhur; ➤ <i>përdor</i> aparatit matematikor, por <i>bën gabime të vogla</i> në procesin (p.sh. në konvertimin e njësive matëse, ose në lidhje me figura të rëndësishme); ➤ <i>jep shpjegime të pjesshme</i> lidhur me fenomenin apo zbatimin e tij.	Nxënësi : ➤ <i>arsyeton</i> shpjegimet e tij duke zbatuar parimet e njohura shkencore ose teknologjike; ➤ tregon se ai ka zotëruar aftësinë për të aplikuar konceptet kryesore kimike; ➤ <i>jep shpjegime koherente dhe të plota</i> bazuar në parimet kryesore të kimisë; ➤ <i>pasuron shpjegimet</i> e tij duke përdorur aparatit matematikor; ➤ <i>identifikon efektet e mundshme</i> të fenomenit apo zbatimit të tij në situata të tjera të reja.

Kompetenca III: Komunikimi i ideve kimike duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës”

Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi shkëmben informacione shkencore me të tjerët. Ai merr parasysh përbërjen e audiencës, përdor mënyra të ndryshme për prezantimin e informacionit dhe përshtat mesazhin e tij, duke përdorur terma shkencore dhe teknologjike, me gojë ose me shkrim, si



dhe bën lidhjen midis koncepteve kimike dhe paraqitjes së tyre në mënyrë grafike ose simbolike. Nxënësi prezanton idetë që lidhen me konceptet të përgjithshme si : gazet, ndryshimet e energjisë në reaksionet, shpejtësia e reaksionit kimik dhe ekuilibri kimik. Ai përdor metodat, strategjitë apo teknikat e duhura, në lidhje me konceptet në analizën cilësore dhe sasiore, sipas kontekstit. Ai përdor informacionin shkencor dhe teknologjik të marrë nga burime të ndryshme duke vërtetuar burimet e informacionit (si autori, të dhënat, ndërreferencat, etj.).

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ➤ jep një mesazh duke paraqitur elementet e tij, pa ia përshtatur atë audiences së synuar; ➤ përdor fjalorin bazë ose mjetet e prezantimit që janë në masë të madhe në kundërshtim me rregullat dhe marrëveshjet.	Nxënësi : ➤ përzgjedh disa informacione në mesazh; ➤ përdor burimet e informacionit që mund të ndryshojnë besueshmërinë e tyre; ➤ organizon dhe përshtat pjesërisht elementet e mesazhit të tij ; ➤ jep një mesazh pa shkelur të drejtat e pronësisë intelektuale; ➤ për koncepte të thjeshta përdor terminologjinë në përputhje me rregullat dhe marrëveshjet; ➤ përzgjedh dhe përdor mjetet e pranueshme të prezantimit për të shfaqur të dhënat.	Nxënësi : ➤ përdor elemente plotësuese shkencore për të rritur cilësinë e komunikimit; ➤ interpreton me saktësi informacionin në mesazh; ➤ përdor gjuhën e duhur në mënyrë që ta bëjë mesazhin e tij më të lehtë për të kuptuar dhe interpretuar; ➤ përzgjedh dhe përdor mjetet e përshtashme të prezantimit; ➤ organizon informacionin e mbledhur në mënyra që ta bëjë më të lehtë për të përpunuar ose interpretuar.



7 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

7.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “QYTETARI”

SHKALLA V		
TEMATIKA: KULTURA		
Përshkrimi i kompetencës që lidhet me këtë tematikë: Në fund të klasës së dhjetë, nxënësi duhet të jetë i aftë të krahasojë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën se si grupet, shoqëritë dhe kulturat plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre; të shpjegojë se si njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore, me këndvështrime dhe pikënisje të ndryshme interpretojnë informacionet dhe përvojat; të shpjegojë dhe të japë shembuj për mënyrën e ndikimit të gjuhës, letërsisë, arteve, traditave, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës; të shpjegojë pse individët dhe grupet reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj mjediseve shoqërore ose fizike dhe ndaj ndryshimeve mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre; të përshkruajë ndikimin dhe bashkëveprimin e diversitetit kulturor si dhe të kohezionit social brenda dhe ndërmjet grupeve.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. dallon raste të trajtimit të veçantë të nevojave dhe interesave njerëzore nga grupe ose kultura të ndryshme;	Nxënësi: a. përshkruan mënyrat në të cilat grupet shoqëritë dhe kulturat trajtojnë nevojat dhe interesat njerëzore; b. shpjegon se si njerëz nga kultura të ndryshme përdorin sisteme të	Nxënësi: a. analizon dhe shpjegon mënyrat në të cilat grupet shoqëritë dhe kulturat trajtojnë nevojat dhe interesat njerëzore; b. parashikon si si mund të interpretohen përvojat dhe të dhënat nga njerëz dhe



b. dallon raste të ndikimit të kulturave të ndryshme në interpretimin e përvojave; c. identifikon elementë të veçantë që luajnë rol në transmetimin ose përshtatjen e kulturave naj mjediseve shoqërore; d. dallon elemente të veçantë që luajnë rol në mirëkuptimin ndërkulturor; e. flet për vlerën e diversitetit kulturor si dhe të kohezionit brenda dhe ndërmjet grupeve; f. dallon raste të ndikimeve të veçanta të njerëzve nga kultura të ndryshme për çështje të përbashkëta njerëzore; g. përdor elementë të veçantë të kërkimit në trajtimin e çështjeve të problemeve shoqërore; h. identifikon këndvështrime të ndryshme aktuale dhe historike brenda	ndryshme referimi për interpretimin e përvojave të tyre ; c. përshkruan modelet shoqërore për ruajtjen dhe transmetimin e kulturave, krahas përshtatjes së tyre ndaj ndryshimeve mjedisore dhe shoqërore; d. përshkruan modelet e sjelljeve që reflektojnë vlerat dhe qëndrimet që ndihmojnë ose pengojnë mirëkuptimin ndërkulturor; e. përshkruan vlerën e diversitetit kulturor si dhe të kohezionit brenda dhe ndërmjet grupeve; f. përshkruan se si kultura të ndryshme reagojnë ndaj çështjeve njerëzore; g. zbaton ide, teori dhe mënyra e kërkimit në shqyrtimin e çështjeve të problemeve shoqërore; h. përshkruan këndvështrimet e ndryshme aktuale dhe historike brenda një kulture dhe ndërmjet kulturave për çështje të ndryshme shoqërore;	këndvështrime të ndryshme kulturore dhe sisteme të ndryshme referimi; c. analizon modelet shoqërore për ruajtjen dhe transmetimin e kulturave, krahas përshtatjes së tyre ndaj ndryshimeve mjedisore dhe shoqërore; d. interpretton modelet e sjelljeve që reflektojnë vlerat dhe qëndrimet që ndihmojnë ose pengojnë mirëkuptimin ndërkulturor ; e. argumenton vlerën e diversitetit kulturor si dhe të kohezionit brenda dhe ndërmjet grupeve; f. parashikon reagime të mundshme të kulturave ndaj çështjeve njerëzore; g. shpjegon dhe zbaton ide, teori dhe mënyra e kërkimit në shqyrtimin e çështjeve të problemeve shoqërore; h. analizon dhe interpretton këndvështrimet e ndryshme aktuale dhe historike brenda një kulture dhe ndërmjet kulturave për çështje të ndryshme shoqërore; i. shpjegon lidhjet e tyre personale me sistemet shoqërore dhe kulturore në kohë dhe hapësirë;
---	--	--



një kulture dhe ndërmjet kulturave për çështje të ndryshme shoqërore; i. dallon raste të lidhjeve të tyre personale me grupet shoqërore dhe kulturore ku bën pjesë; j. identifikon raste të ndikimit që kulturat e ndryshme historike dhe bashkëkohore kanë në jetën e përditshme të individit; k. dallon se si elemente të caktuara kulturore, kombëtare ose etnike ndikojnë në ngjarje dhe situata jetësore.	i. përshkruan lidhjet e tyre personale me sistemet shoqërore dhe kulturore në kohë dhe hapësirë; j. përshkruan ndikimet që kulturat e ndryshme historike dhe bashkëkohore kanë në jetën e përditshme të individit; k. përshkruan ndërveprimin e ndikimeve kulturore, kombëtare dhe etnike në ngjarje dhe situata të veçanta jetësore.	j. vlerëson ndikimet që kulturat e ndryshme historike dhe bashkëkohore kanë në jetën e përditshme të individit; k. shqyrton ndërveprimin e ndikimeve kulturore, kombëtare dhe etnike në ngjarje dhe situata të veçanta jetësore.
---	---	--

TEMATIKA: KOHA, VAZHDIMËSIA, NDRYSHIMI

Përshkrimi i kompetencës që lidhet me këtë tematikë:

Në fund të klasës së dhjetë, nxënësi duhet të jetë i aftë të demonstrojë të kuptuarin që njerëz të ndryshëm mund të përshkruajnë të njëjtat ngjarje ose situata në mënyra të ndryshme, por duke dhënë arsye ose evidenca për këndvështrimet e tyre; të identifikojë dhe të përdorë konceptet kyç si kronologjia, rastësia, ndryshimi, konflikti dhe kompleksiteti për të shpjeguar, analizuar dhe treguar lidhjet midis ndryshimit dhe vazhdimësisë; të identifikojë dhe të përshkruajë periudha të caktuara të ndryshimit nëpërmjet kulturave, të tilla si rritja e qytetërimit, zhvillimi i sistemeve të transportit, komunikimit etj.; të identifikojë dhe të përdorë proceset e rëndësishme për të rindërtuar dhe për të riinterpretuar të kaluarën, të tilla si përdorimi i një larmie burimesh që furnizojnë me të dhëna të vlefshme dhe të besueshme; të zhvillojë ndjenja kritike të tilla si simpatia apo skepticizmi lidhur me qëndrimet, vlerat dhe sjelljet e njerëzve në kontekste të ndryshme historike; të përdorë njohjen e fakteve dhe koncepteve të nxjerra nga historia, shfrytëzimin e tyre, për të informuar rreth vendimmarrjes dhe pjesëmarrjes në veprime konkrete për çështjet publike.



NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. dallon raste të ndikimit të njohurive historike në zgjidhjen që njerëzit u bëjnë çështjeve të tyre; b. përdor konceptin e kohës dhe të kronologjisë për të treguar ndryshimin ose vazhdimësinë historike; c. identifikon elemente të ndryshimeve kulturore në zhvillimin e civilizimeve të ndryshme, formimin e qyteteve dhe të ndryshimeve ekonomike, shoqërore dhe politike; d. përdor me <i>vështirësi</i> elemente të hulumtimit kritik për të shpjeguar, interpretuar ngjarjet historike, çështjet e diskutueshme etj.;	Nxënësi: a. tregon që njohuritë historike dhe koncepti i kohës janë produkte shoqërore dhe ndikojnë në zgjedhjet që njerëzit u bëjnë çështjeve që duan t'u përgjigjen dhe në faktet që përdorin për to; b. përshkruan lidhjet ndërmjet modeleve të ndryshimit dhe të vazhdimësisë historike, duke zbatuar koncepte të tilla si koha, kronologjia, ndryshimi, konflikti dhe kompleksiteti; c. përshkruan modele ndryshimi kulturore dhe ndërkulturore si zhvillimi i kulturave dhe civilizimeve të ndryshme, formimin e qyteteve dhe të ndryshimeve ekonomike, shoqërore dhe politike; d. përdor procese të hulumtimit kritik për të shpjeguar, interpretuar ngjarjet historike, çështjet e diskutueshme , duke përdorur burime të ndryshme informacioni dhe të dhënash;	Nxënësi: a. shpjegon që njohuritë historike dhe koncepti i kohës janë produkte shoqërore dhe ndikojnë në zgjedhjet që njerëzit u bëjnë çështjeve që duan t'u përgjigjen dhe në faktet që përdorin për to; b. analizon dhe shpjegon lidhjet ndërmjet modeleve të ndryshimit dhe të vazhdimësisë historike, duke zbatuar koncepte të tilla si koha, kronologjia, ndryshimi, konflikti dhe kompleksiteti; c. analizon modele ndryshimi kulturore dhe ndërkulturore si zhvillimi i kulturave dhe civilizimeve të ndryshme, formimin e qyteteve dhe të ndryshimeve (edhe të revolucioneve) ekonomike, shoqërore dhe politike). d. përdor në <i>mënyrë sistematike</i> proceset e hulumtimit kritik për të shpjeguar, interpretuar ngjarjet historike, çështjet e diskutueshme, duke përdorur burime të ndryshme informacioni dhe të dhënash dhe duke kontrolluar në



e. dallon këndvështrime të ndryshme brenda dhe ndërmjet kulturave që lidhen me çështje të rëndësishme shoqërore; f. zbaton me vështirësi elemente të hulumtimit historik për shqyrtuar zhvillimet historike dhe bashkëkohore.	e. dallon dhe përshkruan këndvështrime të ndryshme historike dhe aktuale brenda dhe ndërmjet kulturave që lidhen me çështje të rëndësishme shoqërore; f. zbaton mënyra të hulumtimit historik për shqyrtuar zhvillimet historike dhe bashkëkohore.	mënyrë të vazhdueshme besueshmërinë e tyre; e. hulumton, interpreton dhe analizon këndvështrimet e ndryshme historike dhe aktuale brenda dhe ndërmjet kulturave që lidhen me çështje të rëndësishme shoqërore, duke dyshuar e në të njëjtën kohë gjykuar në mënyrë kritike; f. zbaton në mënyrë sistematike ide, teori dhe mënyra të hulumtimit historik për të analizuar zhvillimet historike dhe bashkëkohore dhe për të informuar për të vlerësuar veprimet që lidhen me çështjet publike.
---	---	---

TEMATIKA: NJERËZ, VENDE, MJEDISE

Përshkrimi i kompetencës që lidhet me këtë tematikë:

Në fund të klasës së dhjetë, nxënësi duhet të jetë i aftë të përzgjedhë pamje të komunitetit lokal dhe rajonal të cilat ndihmojnë për një të kuptuar të përmasave, formave dhe drejtimeve të mjedisit në këtë komunitet; të krijojë, të interpretojë, të përdorë dhe të dallojë paraqitje të ndryshme të planetit tonë në harta, globe dhe fotografi; të përdorë burime të vlefshme, të dhëna burimore dhe mjete didaktike të tilla si fotografi, harta, libra, gazeta, statistika, si dhe të tjera që ndihmojnë për të bërë përgjithësime, përpunime dhe interpretime rreth bashkëveprimit të njerëzve me vendet dhe mjedisin; të përshkruajë tiparet e mjedisve në nivel lokal, rajonal duke u ndalur te lumenjtë, liqenet, detet, malet, pyjet, etj dhe të shpjegojë marrëdhëniet brenda ekosistemit; të përshkruajë ndryshimet e sistemit si stinët, klimën dhe motin, ciklin ujor, si dhe të identifikojë zakonet e banorëve të zonës lidhur me to. të përshkruajë si



njerëzit krijojnë vende që reflektojnë vlerat dhe idealet e tyre kulturore, si ndërtojnë qendrat e banimit me parqe, qendra biznesi etj.; të ekzaminojë, të interpretojë dhe të analizojë traditat fizike dhe kulturore dhe bashkëveprimet me to, të tilla si përdorimi i tokës, transmetimi kulturor i zakoneve dhe ideve, ndryshimet e ekosistemit etj.; të përshkruajë sesi kanë ndikuar dhe ndikojnë ngjarjet historike dhe faktorët fizikë dhe njerëzorë në zhvillimin lokal, rajonal, kombëtar dhe global. të vëzhgojë dhe të debatojë rreth efekteve sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe krizave që burojnë nga fenomene të tilla si përmbytje, stuhi, thatësira etj.; të propozojë, të krahasojë dhe të vlerësojë alternativat e përdorimit të tokës dhe të burimeve natyrore në komunitete, rajone, kombe dhe në botë.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. dallon faktin që vendndodhja, drejtimi, madhësia dhe forma e vendeve të ndryshme të botës ka karakter relativ; b. identifikon aspekte dhe përmasa të ndryshme të shprehjes së botës ose të pjesëve të veçanta të saj; c. identifikon lidhje ndërmjet nevojave, vlerave e kulturës së njerëzve dhe mjedisve publike dhe private që ata ndërtojnë; d. liston modele të ndryshme fizike dhe kulturore;	Nxënësi: a. flet me shembuj për karakterin relativ të vendndodhjes, madhësisë, formës, drejtimit të vendeve të ndryshme të botës; b. dallon dhe përshkruan aspekte dhe përmasa të ndryshme në të cilat mund të shprehet bota; c. përshkruan si si ndikon nevojat, kultura, vlerat dhe politika e njerëzve në ndërtimin e mjedisve publike dhe private; d. dallon dhe përshkruan modelet fizike dhe kulturore dhe bashkëveprimin e tyre;	Nxënësi: a. shpjegon karakterin relativ të vendndodhjes, drejtimit, madhësisë dhe formës përmes përpunimit të hartave mendore të vendeve të botës; b. interpretin, zbaton dhe krijon informacione të ndryshme që shprehin botën në përmasa dhe aspekte të ndryshme të saj; c. shpjegon se si mjediset publike dhe private që njerëzit ndërtojnë, pasqyrojnë kulturën, nevojat njerëzore, politikën dhe vlerat dhe idealet e tyre aktuale; d. shqyrton, interpretin dhe analizon modelet fizike dhe kulturore dhe bashkëveprimin e tyre;



e. dallon raste të ndikimit të ngjarjeve historike nga faktorë ekonomike e shoqërorë rajonalë dhe globalë; f. identifikon raste ndikimesh të ndryshimeve dhe krizave mjedisore në fushën ekonomike dhe shoqërore; g. dallon elemente të politikave të ndryshme në shfrytëzimin e burimeve të ndryshme në bashkësinë ku jeton.	e. përshkruan mënyrën se si ngjarjet historike kanë ndikuar dhe janë ndikuar nga faktorët ekonomikë e shoqërorë rajonalë e globalë; f. përshkruan ndikimet ekonomike dhe shoqërore që shkaktojnë ndryshimet dhe krizat mjedisore; g. dallon dhe krahason politika alternative për shfrytëzimin e burimeve të ndryshme në komunitet, shtet, rajon dhe botë.	e. analizon dhe vlerëson mënyrën se si ngjarjet historike kanë ndikuar dhe janë ndikuar nga faktorët ekonomikë e shoqërorë rajonalë e globalë; f. analizon dhe të vlerëson ndikimet ekonomike dhe shoqërore që shkaktojnë ndryshimet dhe krizat mjedisore; g. vlerëson dhe propozon, politika alternative për shfrytëzimin e burimeve të ndryshme në komunitet, shtet, rajon dhe botë.
TEMATIKA: ZHVILLIMI INDIVIDUAL DHE IDENTITETI		
Përshkrimi i kompetencës që lidhet me këtë tematikë: Në fund të klasës së dhjetë, nxënësi duhet të jetë i aftë të lidhë ndryshimet personale me kontekstet sociale, kulturore dhe historike. të përshkruajë lidhjet personale me vendin të shoqëruar me komunitetin, kombin, rajonin dhe botën; të përshkruajë mënyrat sesi familja, gjinia, etniciteti, kombësia dhe lidhjet institucionale kontribuojnë në identitetin e personit; të lidhë faktorë të tillë si mjedisi dhe aftësitë fizike me të mësuarin, motivimin, personalitetin, perceptimin dhe sjelljen për zhvillimin individual; të identifikojë dhe të përshkruajë mënyrat sesi kulturat rajonale, etnike dhe kombëtare, ndikojnë në jetën e përditshme të individit; të identifikojë dhe të përshkruajë ndikimin e perceptimit, qëndrimeve, vlerave dhe besimeve në identitetin personal; të identifikojë dhe të interpretojë shembujt e indiferencës dhe të solidaritetit. të punojë në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim për arritjen e qëllimeve.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: a. identifikon elementë që shprehin lidhjet e tij personale me kohën, hapësirën dhe sistemet social-kulturore; b. identifikon raste të ndikimeve të kulturave historike dhe bashkëkohore në jetën individuale; c. dallon raste të ndikimit të familjes, gjinisë, fesë, statusit ekonomik dhe social etj në zhvillimin e ndjenjës së identitetit personal; d. përdor me vështirësi koncepte të ndryshme për studimin e rritjes dhe zhvillimit njerëzor si: zhvillimi fizik, të nxënit, motivimi, sjellja, perceptimi, dhe personaliteti; e. dallon raste të ndikimeve kulturore, etnike ose kombëtare në dukuri ose situata të veçanta; f. flet për rolin e perceptimeve, qëndrimeve, vlerave dhe bindjeve në zhvillimin e identitetit personal;	Nxënësi: a. përshkruan lidhjet e tij personale me kohën, hapësirën dhe sistemet social-kulturore; b. përshkruan ndikimet e kulturave historike dhe bashkëkohore në jetën individuale; c. përshkruan mënyrat se si familja, feja, gjinia, etnia, kombësia, statusi social-ekonomik faktorë të tjerë kulturore ose të grupeve ndikojnë ndaj zhvillimit të ndjenjës së identitetit personal; d. përdor koncepte të ndryshme për studimin e rritjes dhe zhvillimit njerëzor si: zhvillimi fizik, të nxënit, motivimi, sjellja, perceptimi, dhe personaliteti; e. përshkruan ndërveprimin e ndikimeve kulturore, etnike ose kombëtare në dukuri ose situata të veçanta; f. përshkruan rolin e perceptimeve, qëndrimeve, vlerave dhe bindjeve në zhvillimin e identitetit personal;	Nxënësi: a. analizon lidhjet e tij personale me kohën, hapësirën dhe sistemet social-kulturore; b. vlerëson ndikimet e kulturave historike dhe bashkëkohore në jetën individuale; c. shpjegon mënyrat se si familja, feja, gjinia, etnia, kombësia, statusi social-ekonomik faktorë të tjerë kulturore ose të grupeve ndikojnë ndaj zhvillimit të ndjenjës së identitetit personal; d. zbaton në mënyrë sistematike koncepte, metoda dhe teori për studimin e rritjes dhe zhvillimit njerëzor si: zhvillimi fizik, të nxënit, motivimi, sjellja, perceptimi, dhe personaliteti; e. analizon ndërveprimin e ndikimeve kulturore, etnike ose kombëtare në dukuri ose situata të veçanta; f. analizon rolin e perceptimeve, qëndrimeve, vlerave dhe bindjeve në zhvillimin e identitetit personal;
--	---	---



g. dallon raste të ndikimit të sjelljeve konformiste, altruiste ose stereotipa tek individët dhe grupet;	g. përshkruan ndikimin që ushtrojnë stereotipat, konformizmi, altruizmi dhe sjellje të tjera tek individët dhe grupet;	g. vlerëson ndikimin që ushtrojnë stereotipat, konformizmi, altruizmi dhe sjellje të tjera tek individët dhe grupet;
h. identifikon faktorë që ndikojnë në zhvillimin ose dëmtimin e shëndetit mendor.	h. shqyrton faktorët që ndikojnë në zhvillimin ose dëmtimin e shëndetit mendor. Përshkruan çështjet që lidhen me shëndetin mendor dhe çrregullimet e sjelljes në shoqërinë bashkëkohore.	h. shpjegon faktorët që ndikojnë në zhvillimin ose dëmtimin e shëndetit mendor. Analizon çështjet që lidhen me shëndetin mendor dhe çrregullimet e sjelljes në shoqërinë bashkëkohore.

TEMATIKA: INDIVIDËT, GRUPET, INSTITUCIONET

Përshkrimi i kompetencës që lidhet me këtë tematikë:

Në fund të klasës së dhjetë, nxënësi duhet të jetë i aftë të demonstrojë të kuptuarin e koncepteve të tilla si roli, statusi dhe klasa sociale në përshkrimin e ndërveprimit të individit me grupet sociale; të analizojë ndikimet e grupit dhe të institucioneve tek njerëzit, ngjarjet dhe elementet e kulturës; të përshkruajë forma të ndryshme sesi institucionet marrin pjesë dhe bashkëveprojnë me njerëzit; të identifikojë dhe të analizojë shembuj tensionesh midis shprehjeve të individualitetit dhe grupit ose përpjekjeve institucionale për të vënë në lëvizje konformitetin social; të identifikojë dhe të përshkruajë shembuj të tensioneve midis sistemeve të besimit dhe ligjeve dhe politikave të qeverisjes; të përshkruajë rolin e institucioneve për të përshpejtuar vazhdimësinë dhe ndryshimin njëkohësisht; të zbatojë njohuritë sesi grupet dhe institucionet punojnë për të përmbushur nevojat individuale dhe për të nxitur të mirën e përgjithshme.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. përdor me vështirësi koncepte të tilla si roli, statusi dhe klasa shoqërore për	Nxënësi: a. përdor koncepte të tilla si roli, statusi dhe klasa shoqërore për të përshkruar	Nxënësi: a. zbaton sistematikisht koncepte të tilla si roli, statusi dhe klasa shoqërore për



të përshkruar lidhjet dhe ndërveprimin e individëve, grupeve dhe institucioneve në shoqëri; b. liston raste të ndikimit të grupeve dhe institucioneve të njerëzit, ngjarjet dhe elementët e ndryshëm kulturorë në të kaluarën dhe sot; c. flet për ndryshime të institucioneve në kohë dhe hapësirë; d. dallon raste të përpjekjeve të grupeve dhe institucioneve për të nxitur konformizmin shoqëror. e. dallon raste të ndikimit të besimeve në ligjet e shoqërisë së të kaluarës dhe të sotme; f. nxjerr në pah raste të ndikimit të institucioneve në fushën e trashëgimisë dhe të ndryshimit shoqëror; g. tregon raste të plotësimit ose jo të interesave të individëve ose të interesave të përbashkëta nga institucionet dhe grupet shoqërore;	lidhjet dhe ndërveprimin e individëve, grupeve dhe institucioneve në shoqëri; b. përshkruan ndikimin e grupeve dhe institucioneve të njerëzit, ngjarjet dhe elementët e ndryshëm kulturorë në të kaluarën dhe sot; c. përshkruan zhvillimin e institucioneve në kohë dhe hapësirë; d. identifikon shembuj të kontradiktave ndërmjet shprehjes së individualitetit dhe përpjekjeve që bëhen për të nxitur konformizmin shoqëror nga grupet dhe institucionet. e. përshkruan besimet që qëndrojnë në themel të traditave dhe ligjeve në shoqërinë e sotme dhe gjatë historisë; f. përshkruan rolin e institucioneve si në drejtim të trashëgimisë dhe vazhdimësisë ashtu edhe në drejtimin të ndryshimit; g. përshkruan me shembuj shkallën në të cilën grupe dhe institucionet plotësojnë interesat e individëve dhe interesat e përbashkët në shoqërinë e sotme dhe në atë të së kaluarës.	të përshkruar lidhjet dhe ndërveprimin e individëve, grupeve dhe institucioneve në shoqëri; b. analizon ndikimin e grupeve dhe institucioneve të njerëzit, ngjarjet dhe elementët e ndryshëm kulturorë në të kaluarën dhe sot; c. shpjegon zhvillimin e institucioneve në kohë dhe hapësirë; d. analizon shembuj të kontradiktave ndërmjet shprehjes së individualitetit dhe përpjekjeve që bëhen për të nxitur konformizmin shoqëror nga grupet dhe institucionet. e. shqyrton sistemet e besimeve që qëndrojnë në themel të traditave dhe ligjeve në shoqërinë e sotme dhe gjatë historisë; f. vlerëson rolin e institucioneve si në drejtim të trashëgimisë dhe vazhdimësisë ashtu edhe në drejtimin të ndryshimit; g. analizon shkallën në të cilën grupe dhe institucionet plotësojnë interesat e individëve dhe interesat e përbashkët në shoqërinë e sotme dhe në atë të së kaluarës.
--	---	---



TEMATIKA: PUSHTETI, AUTORITETI, QEVERISJA		
Përshkrimi i kompetencës që lidhet me këtë tematikë: Në fund të klasës së dhjetë, nxënësi duhet të jetë i aftë të ekzaminojë në mënyrë të vazhdueshme çështjet që përfshijnë të drejtat, rolet dhe statusin individual në lidhje me mirëqenien e përgjithshme; të përshkruajë qëllimin e qeverisjes dhe sesi janë ruajtur, përdorur dhe justifikuar fuqitë e saj; të analizojë dhe të përshkruajë idetë dhe mekanizmat qeveritare për të përmbushur nevojat dhe dëshirat e qytetarëve, për të rregulluar territorin, për të menaxhuar konfliktet dhe për të vendosur rregull dhe siguri; të përshkruajë sesi mënyrat e organizimit të kombeve i përgjigjen forcave të unitetit dhe diversitetit duke ndikuar në rregullin dhe sigurinë; të identifikojë dhe të përshkruajë tiparet bazë të sistemit politik në vendin tonë, dhe të identifikojë udhëheqësit përfaqësues nga nivele dhe degë të ndryshme të qeverisjes; të shpjegojë kushtet, veprimet dhe motivimet që kontribuojnë për bashkëpunimin dhe konfliktin brenda dhe ndërmjet kombeve; të përshkruajë dhe të analizojë rolin e teknologjisë në komunikim, transport, procesin e informimit, si dhe zhvillimin në fusha të tjera që kontribuojnë për të zgjidhur konfliktet; të shpjegojë dhe të zbatojë koncepte të tilla si fuqia, roli, statusi, drejtësia, dhe ndikimi për ekzaminimin e e çështjeve të përhershme dhe problemeve sociale; të japë shembuj dhe të shpjegojë se si qeveritë përpiqen të arrijnë idealet e deklaruara brenda dhe jashtë vendit.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. përmend disa nga funksionet e qeverisjes si dhe rrugët e fitimit dhe ushtrimit të pushtetit; b. identifikon forma të ndryshme që qytetarët përdorin për të plotësuar nevojat dhe dëshirat e tyre;	Nxënësi: a. përshkruan funksionet kryesore të qeverisjes si dhe rrugën e fitimit, ushtrimit dhe justifikimit të pushtetit; b. përshkruan mekanizmin me anë të të cilit qytetarët duhet të përdorin për plotësimin e disa prej nevojave dhe dëshirave të tyre etj.;	Nxënësi: a. shpjegon qëllimin e qeverisjes. Analizon rrugën si si fitohet, ushtrohet dhe justifikohet pushteti; b. shpjegon idetë dhe mekanizmin që duhet për plotësimin e nevojave dhe dëshirave të qytetarëve;



c. përmend forma të ndryshme të reagimeve të kombeve dhe organizatave ndaj konflikteve; d. dallon elemente të përbashkëta të sistemit politik shqiptar me një sistem tjetër politik të dhënë; e. përmend faktorë të veçantë që ndihmojnë në konfliktet brenda dhe ndërmjet kombeve; f. përdor me vështirësi elemente të hulumtimit të shkencave politike për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme dhe të problemeve shoqërore.	c. përshtkruan mënyrat se si kombet dhe organizatat e ndryshme u përgjigjen konflikteve ndërmjet forcës së unitetit dhe të diversitetit; d. përshtkruan tiparet kryesore të sistemit politik shqiptar dhe i krahason ato me tiparet e një sistemi tjetër politik; e. përshtkruan kushtet, veprimet dhe motivimet që ndihmojnë në konfliktet dhe bashkëpunimin brenda dhe ndërmjet kombeve. f. zbaton mënyra të hulumtimit të shkencave politike për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme dhe të problemeve shoqërore.	c. analizon mënyrën se si kombet dhe organizatat e ndryshme u përgjigjen konflikteve ndërmjet forcës së unitetit dhe të diversitetit; d. krahason sistemet e ndryshme politike (ideologjitë, strukturën, institucionet, proceset dhe kulturat politike) me sistemin shqiptar; e. analizon dhe vlerëson kushtet, veprimet dhe motivimet që ndihmojnë në konfliktet dhe bashkëpunimin brenda dhe ndërmjet kombeve. f. shpjegon dhe zbaton sistematikisht ide, teori dhe mënyra të hulumtimit të shkencave politike për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme dhe të problemeve shoqërore.
TEMATIKA: PRODHIMI, SHPËRNDARJA, KONSUMI		
Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë: Në fund të klasës së dhjetë, nxënësi duhet të jetë i aftë të japë dhe të përshkruajë shembuj për mënyrat se si sistemet ekonomike bëjnë zgjedhjet e tyre për prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave materiale dhe shërbimeve; të përshkruajë rolin që luajnë oferta, kërkesa, mënyra e shpërbërimit, çmimi dhe fitimet në përcaktimin e asaj që prodhohet dhe shpërndahet në një sistem konkurrencial tregu; të shpjegojë ndryshimin që ekziston ndërmjet të mirave dhe shërbimeve të sektorit privat dhe atij publik; të përshkruajë shembuj të ndryshëm të institucioneve që formojnë sistemet ekonomike si prodhimi i vogël (edhe ai familjar), firmat prodhuese, bankat, institucionet qeveritare, sindikatat dhe korporatat; të përshkruajë rolin e specializimeve dhe të shkëmbimit në proceset ekonomike; të përshkruajë dhe të tregojnë me shembuj për ndikimin e vlerave dhe bindjeve në vendimet e ndryshme ekonomike; të bëjë dallimin		



ndërmjet formave të ndryshme të shkëmbimit dhe parave; të krahasojë sistemet kryesore ekonomike bazuar në kriterin se kush përcakton prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e të mirave dhe shërbimeve; të përdorë koncepte ekonomike për të shpjeguar zhvillimet aktuale dhe historike dhe çështjet në kontekstin lokal, kombëtar dhe global; të përdorë arsyetimin ekonomik për të krahasuar propozimet e ndryshme që lidhen me çështje shoqërore bashkëkohore si papunësia, shiu acid ose cilësia e arsimit.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. dallon burime të pamjaftueshme në fusha të caktuara dhe flet për nevojën e rregullimeve në fushën e prodhimit dhe shpërndarjes së të mirave dhe shërbimeve; b. dallon aspekte të caktuara të rolit që luan kërkesa, oferta, çmimi etj. Në prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve në një sistem konkurrencial tregu; c. dallon elemente të veçanta të koston dhe të fitimit dhe të rolit të tyre në shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve në sektorin privat dhe atë publik;	Nxënësi: a. përshkruan se si pamjaftueshmëria e burimeve prodhuese kërkon zhvillimin e sistemeve ekonomike që marrin vendimet për prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve; b. përshkruan rolin që luajnë kërkesa, oferta, çmimi, shpërblimi dhe fitimi, kosto në prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve në një sistem konkurrencial tregu; c. përshkruan rëndësinë që ka kosto dhe fitimi për shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve në sektorin privat dhe atë publik; d. përshkruan aspektet kryesore të marrëdhënieve ndërmjet	Nxënësi: a. shpjegon pse pamjaftueshmëria e burimeve prodhuese kërkon zhvillimin e sistemeve ekonomike që marrin vendimet për prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve; b. analizon rolin që luajnë kërkesa, oferta, çmimi, shpërblimi dhe fitimi, kosto etj. Në prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve në një sistem konkurrencial tregu. Shpjegon marrëdhëniet ndërmjet tyre; c. shpjegon rëndësinë që ka kosto dhe fitimi për shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve në sektorin privat dhe atë publik; d. analizon dhe shpjegon marrëdhëniet ndërmjet institucioneve të ndryshme



d. identifikon aspekte të veçanta të lidhjeve ndërmjet institucioneve të ndryshme ekonomike, si prodhimi i vogël (edhe ai familjar), firmat prodhuese, bankat, institucionet qeveritare, sindikatat dhe korporatat; e. përdor <i>rrallë dhe me vështirësi</i> koncepte dhe arsyeime ekonomike për vlerësimin e zhvillimeve dhe çështjeve shoqërore aktuale dhe historike; f. dallon elemente të veçanta të sistemeve ekonomike të brendshëm dhe ato globale si dhe aspekte të veçanta të lidhjes ndërmjet tyre; g. përdor me <i>vështirësi</i> njohuritë për prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin në analizën e çështjeve shoqërore.	institucioneve të ndryshme ekonomike që përbëjnë sistemet ekonomike si prodhimi i vogël (edhe ai familjar), firmat prodhuese, bankat, institucionet qeveritare, sindikatat dhe korporatat; e. përdor koncepte dhe arsyeime ekonomike për vlerësimin e zhvillimeve dhe çështjeve shoqërore aktuale dhe historike; f. përshkruan karakteristikat e sistemeve ekonomike të brendshme dhe globale si dhe forma të bashkëveprimit ndërmjet tyre; g. përdor njohuritë për prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin në analizën e çështjeve shoqërore.	ekonomike që përbëjnë sistemet ekonomike si prodhimi i vogël (edhe ai familjar), firmat prodhuese, bankat, institucionet qeveritare, sindikatat dhe korporatat; e. zbaton <i>sistematikisht</i> konceptet dhe arsyeimet ekonomike për vlerësimin e zhvillimeve dhe çështjeve shoqërore aktuale dhe historike; f. shpjegon sistemet ekonomike të brendshëm dhe ato globale dhe bashkëveprimin ndërmjet tyre; g. zbaton <i>vazhdimisht</i> njohuritë për prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin në analizën e çështjeve shoqërore. Harton një plan për plotësimin e kërkesave shoqërore të dëshirueshme që lidhen me to.
---	--	--

TEMATIKA: SHKENCA, TEKNOLOGJIA, SHOQËRIA

Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë:

Në fund të klasës së dhjetë, nxënësi duhet të jetë i aftë të shqyrtojë dhe të përshkruajë ndikimin e kulturës në zgjedhjet dhe arritjet e shkencës dhe teknologjisë, si në transport, mjekësi, mirëqenie etj.; të tregojë përmes shembujve specifikë sesi shkenca dhe teknologjia kanë ndryshuar perceptimet e njerëzve për botën natyrore dhe sociale, si marrëdhëniet e tyre me tokën, jetën e kafshëve,



jetën familjare, nevojat dhe dëshirat ekonomike dhe sigurinë; të përshkruajë shembuj në të cilat vlerat, besimet dhe qëndrimet janë ndikuar nga zbulimet e reja shkencore dhe teknologjike, si shpikja e shtypit, konceptimi i universit, zbatimi i energjisë atomike dhe zbulimet gjenetike; të shpjegojë nevojën për ligje dhe politika për të qeverisur zbatimet shkencore dhe teknologjike, të tilla si siguria dhe mirëqenia e punëtorëve dhe e konsumatorëve, rregullimi gjërave të dobishme si radio, televizioni etj..

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. identifikon, nga historia dhe aktualiteti, raste të bashkëveprimit dhe të ndërvarësisë së shkencës, teknologjisë dhe të shoqërisë; b. dallon raste të ndikimit që sjell shkenca dhe teknologjia në fushën e mjedisit fizik dhe në atë shoqëror; c. dallon raste të ndikimit të shkencës dhe teknologjisë në vlerat dhe qëndrimet themelore të shoqërisë;	Nxënësi: a. përshkruan shembuj bashkëveprimit dhe të ndërvarësisë së shkencës, teknologjisë dhe të shoqërisë; b. përshkruan shembuj të transformimit të shoqërisë dhe mjedisit fizik nga shkenca dhe teknologjia; c. përshkruan, me shembuj, ndikimin e shkencës dhe teknologjisë në vlerat dhe qëndrimet themelore të shoqërisë dhe anasjelltas;	Nxënësi: a. analizon, nga historia dhe aktualiteti, shembuj të bashkëveprimit dhe të ndërvarësisë së shkencës, teknologjisë dhe të shoqërisë në mjedise të ndryshme kulturore; b. gjykon për mënyrën se si shkenca dhe teknologjia kanë transformuar mjedisin fizik dhe shoqërinë njerëzore si dhe mënyrën e të kuptuarit të kohës, hapësirës dhe të bashkëveprimit njerëzor; c. analizon se si shkenca dhe teknologjia kanë ndikuar dhe ndikojnë në vlerat, bindjet dhe qëndrimet themelore të shoqërisë dhe si si vlerat, bindjet dhe qëndrimet e shoqërisë kanë modeluar ndryshimet shkencore dhe teknologjike; d. vlerëson politikat e ndryshme që janë propozuar për trajtimin e ndryshimeve



d. riprodhon qëndrime të caktuara për trajtimin e ndryshimeve shoqërore që kanë qenë rrjedhojë e teknologjive të reja si inxhinieria gjenetike për bimët dhe kafshët;	d. gjykon politika të caktuara të propozuara për trajtimin e ndryshimeve shoqërore që kanë qenë rrjedhojë e teknologjive të reja si inxhinieria gjenetike për bimët dhe kafshët;	shoqërore që kanë qenë rrjedhojë e teknologjive të reja si inxhinieria gjenetike për bimët dhe kafshët. Dhe propozon në mënyrë krijuese politika për trajtimin e ndryshimeve shoqërore që kanë qenë rrjedhojë e teknologjive të reja;
e. mban qëndrime të caktuara jo të pavarura për këndvështrimet e ndryshme për shoqërinë njerëzore dhe botën fizike;	e. pranon dhe gjykon këndvështrimet e ndryshme për shoqërinë njerëzore dhe botën fizike duke përdorur njohuritë shkencore, standardet etike dhe teknologjitë që vijnë nga kultura të ndryshme botërore;	e. pranon dhe interpreton këndvështrimet e ndryshme për shoqërinë njerëzore dhe botën fizike duke përdorur <i>vazhdimisht</i> njohuritë shkencore, standardet etike dhe teknologjitë që vijnë nga kultura të ndryshme botërore;
f. merr pjesë me ide të pjesshme në diskutimet publike për çështje të marrëdhënieve ndërmjet teknologjisë dhe shoqërisë.	f. zbaton strategji dhe politika zhvillimi për të ndikuar në diskutimet publike për çështje të marrëdhënieve ndërmjet teknologjisë dhe shoqërisë si për shembull efekti serrë.	f. formulon strategji dhe politika zhvillimi për të ndikuar në diskutimet publike për çështje të marrëdhënieve ndërmjet teknologjisë dhe shoqërisë, sipër shembull efekti serrë.

TEMATIKA: LIDHJET GLOBALE

Përshkrimi i kompetencës që lidhet me këtë tematikë:

Në fund të klasës së dhjetë, nxënësi duhet të jetë i aftë të përshkruajë me shembuj ndikimin (lehtësimin ose jo) e elementëve kulturorë si gjuha, arti, muzika, besimet etj. në mirëkuptimin ose keqkuptimin në nivel global; të analizojë shembuj bashkëpunimi,



ndërvarësie ose konfliktesh ndërmjet individëve, grupeve ose kombeve; të përshkruajë dhe të analizojë ndikimin e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global. të shqyrtojë shkaqe, pasoja dhe zgjidhje të mundshme të disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose reja si shëndeti, sigurimi, shpërndarja e burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit; të përshkruajë dhe të shpjegojë marrëdhëniet dhe kontradiktat ndërmjet sovranitetit kombëtar dhe interesave globale në çështje të tilla si territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë dhe mirëqenia e popujve; të dëshmojë me shembuj praktikë nivelin e të kuptuarit të çështjeve, standardeve dhe konflikteve lidhur me të drejtat e njeriut dhe çështje të tjera globale; të identifikojë dhe të përshkruajë rolin e organizmave ndërkombëtarë dhe të organizatave ndërshtetërore.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. identifikon raste të lidhjeve ndërmjet të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes; b. dallon, raste të lidhjeve të këndvështrimeve të njerëzve me faktorë të tillë si mosha, besimi, kultura, konteksti gjeografik, gjuha, kombësia, raca etj.; c. identifikon raste të ndikimit të elementëve kulturorë si gjuha, arti, muzika, besimet etj. Në mirëkuptimin ose keqkuptimin në nivel global;	Nxënësi: a. përshkruan me shembuj ndërvarësinë e grupeve ose kombeve; b. përshkruan dhe jep mendimin e tij për ndikimin e e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global. c. identifikon shkaqe, pasoja dhe zgjidhje të mundshme të disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose reja si: shëndeti, sigurimi, shpërndarja e	Nxënësi: a. shpjegon me shembuj ndërvarësinë globale, lidhjen e të kaluarës, tashmes e të ardhmes dhe ndërvarësinë e sjelljeve dhe veprimeve të individëve me sistemet globale; b. argumenton me shembuj se këndvështrimet për botën ndryshojnë në varësi të faktorëve të tilla si mosha, besimi, kultura, konteksti gjeografik, gjuha, kombësia, raca etj.; c. shpjegon me shembuj ndikimin (lehtësues ose jo) e elementëve kulturorë si gjuha, arti, muzika, besimet etj. Në mirëkuptimin ose keqkuptimin në nivel global;



d. liston motive që ndihmojnë në nivelin e bashkëpunimit ose të konflikteve; e. përmend raste të ndikimit të ndryshimeve teknologjike në komunitetin global; f. identifikon disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose reja, si: shëndeti, sigurimi, shpërndarja e burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit etj.; g. dallon probleme të veçanta, të shkëputura që lidhen me marrëdhëniet ndërmjet sovranitetit kombëtar dhe interesave globale;	burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit etj.; d. dallon dhe përshkruan disa nga tiparet e marrëdhënieve ndërmjet sovranitetit kombëtar dhe interesave globale në çështje të tilla si territori, zhvillimi ekonomik, armët bërthamore dhe ato në përgjithësi, përdorimi i burimeve natyrore dhe shqetësimet lidhur me të drejtat e njeriut; e. formulon mendimin e tij për çështje që lidhen me të drejtat e njeriut, konfliktet ose çështje të tjera globale; f. përshkruan rolin e organizatave ndërkombëtare dhe ndërshtetërore në nivel global; g. identifikon dhe përshkruan ndikimet e mundshme të veprimeve individuale dhe kolektive në të tashmen dhe ta ardhmen globale;	d. shpjegon kushtet dhe motivet që ndihmojnë në nivelin e bashkëpunimit, të ndërvarësisë dhe të konflikteve ndërmjet individëve, grupeve ose kombeve; e. analizon dhe vlerëson ndikimin e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global; f. analizon shkaqe, pasoja dhe zgjidhje të mundshme të disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose reja si: shëndeti, sigurimi, shpërndarja e burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit etj.; g. analizon marrëdhëniet dhe kontradiktat ndërmjet sovranitetit kombëtar dhe interesave globale në çështje të tilla si territori, zhvillimi ekonomik, armët bërthamore dhe ato në përgjithësi, përdorimi i burimeve
---	--	--



h. shpreh mendime për çështje globale të njohura dhe të diskutuara gjerësisht në publik; i. Liston disa prej funksioneve të organizatave ndërkombëtare dhe ndërshtetërore në nivel global; j. identifikon ndikime të mundshme të veprimeve individuale dhe kolektive në të tashmen dhe të ardhmen e bashkësisë ku jeton.	h. lidh çështjet globale të njohura dhe të diskutuara në publik me interesat vetjake dhe kombëtare; i. përshkruan rolin e organizatave ndërkombëtare për zgjidhjen e probleme globale; j. përshkruan se si ndikojnë veprimet individuale dhe kolektive në të tashmen dhe të ardhmen e bashkësisë.	natyrore dhe shqetësimet lidhur me të drejtat e njeriut. h. analizon ose formulon <i>qartë</i> deklarata politike që dëshmojnë në praktikë nivelin e të kuptuarit të çështjeve, standardeve dhe konflikteve lidhur me të drejtat e njeriut dhe çështje të tjera globale; i. vlerëson rolin e organizatave ndërkombëtare dhe ndërshtetërore në nivel global; j. analizon dhe parashikon ndikimin e mundshëm të veprimeve individuale dhe kolektive në të tashmen dhe të ardhmen globale.
--	---	--

TEMATIKA: IDEALET DHE PRAKTIKAT E QYTETARISË

Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë:

Në fund të klasës së dhjetë, nxënësi duhet të jetë i aftë të shqyrtojë origjinën dhe ndikimin e vazhdueshëm të idealeve të shoqërisë demokratike si dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës; të identifikojë dhe të interpretojë burimet e të drejtave të njeriut si dhe shembuj të tyre në jetën e përditshme; të gjejë, të grumbullojë, organizojë dhe shfrytëzojë informacion për çështje të veçanta publike, duke njohur dhe shpjeguar këndvështrimet e ndryshme për to; të praktikojë forma të caktuara të diskutimeve dhe



të pjesëmarrjes publike që janë në përputhje me idealet e qytetarisë në një shoqëri demokratike; të shpjegojë dhe të analizojë veprimet e ndryshme që qytetarët duhet të ndërmarrin për të ndikuar në vendimet e politikës publike; të identifikojë dhe të shpjegojë rolin që luajnë aktorët e ndryshëm politikë që veprojnë në sektorin publik dhe në shoqërinë civile në hartimin dhe modelimin e politikës publike dhe të procesit të vendimmarrjes; të analizojë ndikimin e formave të ndryshme të opinionit publik në zhvillimin politikës dhe në procesin e vendimmarrjes për çështjet publike; të analizojë efektshmërinë e politikave të caktuara publike dhe të sjelljeve të qytetarëve në realizimin e idealeve të shoqërisë demokratike; të shpjegojë marrëdhëniet ndërmjet politikave të shpallura dhe planit të veprimeve që përdoret për të trajtuar çështjet në interes të përbashkët; të shqyrtojnë strategjitë e hartuara për realizimin dhe fuqizimin e të mirës së përbashkët.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. identifikon dhe përshkruan raste të ndikimit të idealeve themelore demokratike në jetën e përditshme; b. përshkruan lidhjen e të drejtave me faktorë të ndryshëm jetësorë; c. dallon larminë e këndvështrimeve të ndryshme; d. merr pjesë në forma të diskutimit dhe të pjesëmarrjes qytetare në përputhje me idealet e qytetarisë demokratike;	Nxënësi: a. përshkruan ndikimin e vazhdueshëm të idealeve themelore demokratike si dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës në jetën e përditshme; b. shpjegon me shembuj burimin e të drejtave dhe të përgjegjësisë të qytetarëve; c. përshkruan larminë e këndvështrimeve të ndryshme; d. ushtron me vetëdije forma të diskutimit dhe të pjesëmarrjes qytetare në përputhje me idealet e qytetarisë demokratike;	Nxënësi: a. shpjegon origjinën dhe interpreton ndikimin e vazhdueshëm të idealeve themelore demokratike si dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës në jetën e përditshme b. analizon, interpreton dhe vlerëson burimet dhe shembujt e të drejtave dhe përgjegjësisë të qytetarëve; c. vlerëson larminë e këndvështrimeve të ndryshme; d. ushtron dhe drejton forma të diskutimit dhe të pjesëmarrjes qytetare në përputhje me idealet e qytetarisë demokratike;



e. dallon raste të ndikimit të formave të ndryshme të veprimit qytetar në politikën publike; f. dallon ekzistencën e politikave dhe çështjeve të ndryshme publike; g. dallon dhe përshkruan raste të ndikimit të ndërsjellë të sjelljeve qytetare dhe të idealeve të qytetarisë.	e. përshkruan ndikimin e formave të ndryshme të veprimit qytetar në politikën publike; f. përshkruan këndvështrimet e aktorëve të ndryshëm që ndikojnë politikën kombëtare; g. shpjegon ndikimin e ndërsjellë të politikave publike dhe të sjelljeve qytetare në formimin e idealeve shpallura të qytetarisë demokratike.	e. analizon dhe vlerëson ndikimin e formave të ndryshme të veprimit qytetar në politikën publike; f. analizon larminë e madhe të politikave dhe çështjeve publike nga këndvështrimi i aktorëve të ndryshëm që ndikojnë politikën në kombëtare dhe krijon qëndrimin e tij për to; g. vlerëson shkallën në të cilën politikat publike dhe sjelljet qytetare pasqyrojnë ose ndihmojnë në formimin e idealeve të shpallura të qytetarisë demokratike.
---	---	---

TEMATIKA: TË DREJTAT E NJERIUT

Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë:

Në fund të klasës së dhjetë, nxënësi duhet të jetë i aftë të identifikojë, përshkruajë dhe klasifikojë nevojat dhe dëshirat bazë të qenies njerëzore; të shpjegojë pse plotësimi i nevojave dhe i dëshirave bazë përbën një të drejtë që u takon si atij ashtu edhe të tjerëve; të identifikojë, në dokumentet kryesore të të drejtave të njeriut dhe në kushtetutën shqiptare të drejtat dhe liritë themelore; të dallojë llojet kryesore të të drejtave si të drejtat personale, të drejtat civile dhe politike, të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, të drejtat për një mjedis të shëndetshëm etj. dhe të diskutojë rreth tyre; të shpjegojë me shembuj rëndësinë që kanë të drejtat dhe realizimi i tyre për vete dhe për të tjerët; të vlerësojë, të marrë dhe të mbrojë qëndrime të caktuara lidhur me çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave; të shpjegojë me fjalët e tij se të drejtat veprojnë në një fushë të caktuar dhe ato kanë kufizimet e tyre për shembull, e drejta për informacion dhe shtyp të lirë dhe e drejta e njerëzve për të pasur jetën e tyre private pa ndërhyrje nga të tjerët (edhe nga shtypi) etj.; të dallojë raste të kufizimit të të drejtave në jetën e përditshme (familje, klasë etj)



dhe të tregojë se të drejtat kufizohen nga nevoja për të respektuar të drejta e tij dhe të të tjerëve në emër të harmonisë shoqërore; të respektojë e të ndërmarrë veprime konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të të tjerëve; të shqyrtojnë strategjitë e hartuara për realizmin dhe fuqizimin e të mirës së përbashkët.

Nxënësi: a. dallon të drejtat themelore të njeriut dhe lidhjen e të drejtave me faktorë të ndryshëm jetësorë; b. dallon disa nga vlerat që qëndrojnë në themel të të drejtave të njeriut; c. Dallon elemente të lidhjes ndërmjet etapave historike dhe zhvillimit të përmbajtjes së konceptit të të drejtave të njeriut dhe të llojeve të ndryshme të tyre; d. identifikon dhe klasifikon sipas kronologjisë historike, dokumentet themelore të të drejtave të njeriut; e. dallon liritë dhe të drejtat themelore në ligjin kushtetues shqiptar; f. liston dokumentet themelore kombëtare, evropiane dhe botërore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut;	Nxënësi: a. përshkruan përmbajtjen e të drejtave themelore, kuptimet e ndryshme të konceptit të të drejtave të njeriut dhe burimet e tyre; b. përshkruan vlerat që qëndrojnë në themel të të drejtave të njeriut; c. përshkruan lidhjen ndërmjet etapave historike dhe zhvillimit të përmbajtjes së konceptit të të drejtave të njeriut dhe të llojeve të ndryshme të tyre; d. identifikon dhe përshkruan në kontekstin historik dokumentet themelore të të drejtave të njeriut; e. përshkruan përmbajtjen e ligjit kushtetues shqiptar për liritë dhe të drejtat themelore në veçanti;	Nxënësi: a. shpjegon përmbajtjen e të drejtave themelore, kuptimet e ndryshme të konceptit të të drejtave të njeriut dhe burimet e tyre; b. shpjegon dhe interpreton vlerat që qëndrojnë në themel të të drejtave të njeriut; c. shpjegon lidhjen ndërmjet etapave historike dhe zhvillimit të përmbajtjes së konceptit të të drejtave të njeriut dhe të llojeve të ndryshme të tyre; d. interpreton në kontekstin historik dokumentet themelore të të drejtave të njeriut; e. interpreton përmbajtjen e ligjit kushtetues shqiptar në përgjithësi dhe liritë dhe të drejtat themelore në veçanti; f. analizon dhe vlerëson mbrojtjen e të drejtave të njeriut në dokumentet
--	--	---



g. shprehet për lidhjet ndërmjet llojeve të ndryshme të të drejtave; h. shprehet për lidhjet ndërmjet llojeve të ndryshme të të drejtave.	f. përshkruan mbrojtjen e të drejtave të njeriut në dokumentet themelore kombëtare, evropiane dhe botërore; g. mban një qëndrim të caktuar për lidhjet ndërmjet llojeve të ndryshme të të drejtave; h. mban një qëndrim të caktuar për fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave.	themelore kombëtare, evropiane dhe botërore; g. vlerëson, dhe mbron me argumente qëndrime të caktuara për lidhjet ndërmjet llojeve të ndryshme të të drejtave; h. vlerëson, mban dhe mbron me argumente qëndrime të caktuara për fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave.
---	---	---

7.2 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “HISTORI”

SHKALLA V
Kompetenca I: Kërkimi historik dhe analiza shkak-pasojë
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përcakton dhe kryen kërkim për një ngjarje/çështje të caktuar historike nga historia e qytetërimeve botërore dhe historia e shqiptarëve duke analizuar ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë, pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të



ndryshimeve historike, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, për një periudhë të caktuar historike apo për periudha të ndryshme të shoqërisë, në varësi të ngjarjes/çështjes/figurës, për të cilën zhvillohet kërkimi historik.

Ai identifikon dhe shqyrton, individualisht dhe si pjesë e një grupi, pyetje specifike për historinë e qytetërimeve botërore dhe për historinë e shqiptarëve për periudhën antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore ose çështje që u përkasin këtyre periudhave. Nxënësi nëpërmjet kërkimit për të kaluarën dhe trashëgimisë së saj zhvillon dhe ndërton konceptet historike që lidhen me kohën dhe kronologjinë, vazhdimësinë dhe ndryshimin në marrëdhëniet shoqërore, vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe lidhjen e tyre shkak-pasojë, rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes, nëpërmjet kuptimit të ngjarjeve më të rëndësishme që kanë ndodhur në historinë e shqiptarëve dhe historinë e qytetërimeve botërore në parahistori, në periudhën antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ➤ zhvillon kërkim dhe formulon pyetje që adresojnë vetëm një aspekt të ngjarjes/çështjes apo figurës historike nga historia e shqiptarëve dhe historia e qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike (parahistori, antikitet, mesjetë, moderne dhe bashkëkohore) duke iu referuar ndonjë burimi historik për t'iu përgjigjur pyetjeve për aspektin e ngjarjes për të cilin zhvillon kërkimin; ➤ identifikon disa prej koncepteve që lidhen me kohën dhe kronologjinë, shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare, ndryshimin dhe vazhdimësinë, marrëdhëniet shkak-	Nxënësi : ➤ kërkon dhe formulon pyetje që adresojnë disa nga aspektet thelbësore të një ngjarje/çështje apo figure historike duke përdorur disa prej burimeve historike dhe burimeve të informacionit, për t'iu përgjigjur pyetjeve, për të strukturuar një shqyrtim dhe për të nxjerrë konkluzionet për ngjarjen /çështjen/ figurën historike për të cilën zhvillohet kërkimi historik; ➤ përcakton një çështje për kërkim nga historia e shqiptarëve ose historia e qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike (parahistori, antikitet, mesjetë, moderne dhe bashkëkohore)	Nxënësi : ➤ kërkon, harton dhe drejton pyetje për çështje/ngjarje/figura historike, nga historia e shqiptarëve dhe historia e qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike (parahistori, antikitet, mesjetë, moderne dhe bashkëkohore) dhe kupton se si ato lidhen me një kontekst të gjerë historik; ➤ përcakton një çështje për kërkim, harton dhe drejton pyetje për çështjen/ngjarjen/ figurën historike, duke përdorur një sërë burimesh historike për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të strukturuar një shqyrtim, për zhvillimin e hipotezave, për të nxjerrë dhe për të justifikuar konkluzionet e tyre për



pasojë, ndërveprimin dhe rëndësinë e tyre historike; ➤ dallon lidhjet shkak-pasojë për një periudhë të caktuar historike apo për periudha të ndryshme të shoqërisë në nivel lokal, kombëtar, evropian e botëror, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, për një periudhë të caktuar historike apo për periudha të ndryshme të shoqërisë, në varësi të ngjarjes/çështjes/figurës, për të cilën zhvillohet kërkimi historik; ➤ identifikon ndonjë ndër konceptet historike që lidhen me ngjarjen/çështjen apo figurën historike për të cilën zhvillohet kërkimi; ➤ kryen detyra që nuk adresojnë problemin.	➤ vlerëson ngjarjen/çështjen/figurën historike duke përdorur disa prej koncepteve që lidhen me kohën dhe kronologjinë, shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare, ndryshimin dhe vazhdimësinë, marrëdhëniet shkak-pasojë, ndërveprimin dhe rëndësinë e tyre historike; ➤ identifikon disa ndër lidhjet shkak-pasojë për një periudhë të caktuar historike apo për periudha të ndryshme të shoqërisë në nivel lokal, kombëtar, evropian e botëror, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, për një periudhë të caktuar historike apo për periudha të ndryshme të shoqërisë, në varësi të ngjarjes/çështjes/figurës, për të cilën zhvillohet kërkimi historik; ➤ përdor disa prej koncepteve kryesore që lidhen me ngjarjen çështjen apo figurën historike të marrë në shqyrtim.	ngjarjen /çështjen/ figurën historike për të cilën zhvillohet kërkimi historik; ➤ zhvillon dhe vlerëson ngjarjen/çështjen/ figurën historike duke përdorur drejt dhe saktë konceptet historike që lidhen me kohën dhe kronologjinë, shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare, ndryshimin dhe vazhdimësinë në marrëdhëniet shoqërore, vijimësinë e ngjarjeve, lidhjen shkak-pasojë, ndërveprimin, rëndësinë dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes; ➤ përcakton qartë ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë duke treguar lidhjet e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve, situatave dhe ndryshimeve kryesore, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, për një periudhë të caktuar historike apo për periudha të ndryshme të shoqërisë, në varësi të ngjarjes/çështjes/figurës, për të cilën zhvillohet kërkimi historik; ➤ përdor me lehtësi dhe në mënyrën e duhur konceptet që lidhen me ngjarjen çështjen apo figurën historike të marrë në shqyrtim.
Kompetenca II: Përdorimi i burimeve dhe interpretimi historik		



Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës që i përkasin periudhës antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre gjatë interpretimit të historisë së qytetërimeve botërore dhe historisë së shqiptarëve.

Ai bën testimin e hipotezave, vlerëson burimet e përdorura për të arritur përfundime të arsyetuara dhe logjike, tregon lidhjet e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve, situatave dhe ndryshimeve kryesore, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, për një periudhe të caktuar historike apo për periudha të ndryshme të shoqërisë, në varësi të ngjarjes/çështjes/figurës, për të cilën zhvillohet kërkimi historik;

Nxënësi vlerëson burimet alternative për ndërtimin e ngjarjes për të kuptuar pse historianët dhe të tjerët i kanë interpretuar ngjarjet, njerëzit dhe situatat historike të qytetërimeve botërore dhe të historisë së shqiptarëve që i përkasin një periudhe të caktuar në mënyra të ndryshme.

Nxënësi nëpërmjet përdorimit të burimeve dhe interpretimit të ngjarjeve dhe shoqërive në të kaluarën dhe sot zhvillon dhe ndërton konceptet kyçe historike që lidhen me kohën dhe kronologjinë, vazhdimësinë dhe ndryshimin në marrëdhëniet shoqërore, vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe lidhjen e tyre shkak-pasojë, rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes, nëpërmjet kuptimit të ngjarjeve më të rëndësishme që kanë ndodhur në historinë e shqiptarëve dhe historinë e qytetërimeve botërore në parahistori, në periudhën antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ➤ <i>i referohet ndonjë burimi historik të përcaktuar për t'iu përgjigjur dhe për të interpretuar ndonjë pyetje për ngjarje të caktuara nga historia e shqiptarëve ose historia e qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike;</i>	Nxënësi : ➤ argumenton pjesërisht interpretimin e tij në lidhje me ngjarje apo çështje të caktuara që i përkasin periudhave antike mesjetare moderne dhe bashkëkohore duke identifikuar, zgjedhur dhe përdorur një disa prej burimeve historike (burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik); ➤ përzgjedh disa burime ose informacione të	Nxënësi : ➤ argumenton interpretimin e tij në lidhje me ngjarje apo çështje të caktuara që i përkasin periudhave antike mesjetare moderne dhe bashkëkohore duke identifikuar, zgjedhur dhe përdorur një sërë burimesh historike, (përfshirë burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik)



➤ interpreton aspekte që kanë të bëjnë me ngjarjen historike duke ju referuar pjesërisht burimit të përcaktuar.	rëndësishme për interpretimin e ngjarjeve historike; ➤ përdor disa prej burimeve historike dhe burimeve të informacionit, për t'iu përgjigjur pyetjeve, për të strukturuar një shqyrtim, për të nxjerrë dhe për të interpretuar konkluzionet për një ngjarje të caktuar nga historia e shqiptarëve ose historia e qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike.	➤ përzgjedh me saktësi informacionin historik, duke shfrytëzuar burimet parësore dhe dytësore, dhe e interpreton atë; ➤ vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre; ➤ vlerëson, përdor dhe shfrytëzon një sërë hartash dhe burimesh historike për t'iu përgjigjur pyetjeve, për të strukturuar një shqyrtim, për të zhvilluar hipoteza, për të përzgjedhur faktet, si dhe për të nxjerrë dhe për të interpretuar konkluzionet e tij për një ngjarje të caktuar nga historia e shqiptarëve ose historia e qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike.
--	---	---

Kompetenca III: Shpjegimi dhe komunikimi për të kaluarën

Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi paraqet shpjegime të argumentuara mbështetur në burime për shpjegimin e ngjarjeve të historisë së shqiptarëve dhe historisë së qytetërimeve botërore që janë koherente, të strukturuar dhe të arsyetuara, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik sipas periudhës përkatëse (antike, mesjetare; moderne dhe bashkëkohore).

Ai komunikon njohuritë historike për periudhën antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në mënyra të ndryshme (me gojë, me shkrim ose medie të ndryshme), duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik.

Nxënësi nëpërmjet shpjegimit dhe prezantimit të ngjarjeve dhe shoqërive në të kaluarën dhe sot zhvillon dhe ndërton konceptet kyçe historike që lidhen me kohën dhe kronologjinë, vazhdimësinë dhe ndryshimin në marrëdhëniet shoqërore, vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe lidhjen e tyre shkak-pasojë, rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes, nëpërmjet kuptimit të ngjarjeve më të rëndësishme



që kanë ndodhur në historinë e shqiptarëve dhe historinë e qytetërimeve botërore në parahistori, në periudhën antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ përzgjedh me vështirësi pak informacion që është i rëndësishëm për çështjen apo ngjarjen historike për të cilën zhvillohet kërkimi; ➤ përdor rrallë terminologjinë dhe simbolet historike të mësuara; ➤ përdor me vështirësi hartat dhe burimet historike për prezantimin e informacionit; ➤ prezanton informacionin në mënyrë jo të organizuar.	Nxënësi: ➤ prezanton me ndihmë informacionin përmes përdorimit të burimeve të përcaktuara dhe duke përdorur fjalorin historik; ➤ organizon me ndihmë informacionin në tabela, diagrame; ➤ organizon me ndihmë informacionin dhe e përshtat atë për audiencën; ➤ zgjedh dhe përdor mjete të pranueshme të prezantimit për të shfaqur të dhënat; ➤ përdor me ndihmë burimet dhe hartat historike për prezantimin e informacionit; ➤ përdor në disa raste terminologjinë dhe simbolet historike të mësuara.	Nxënësi: ➤ prezanton informacionin përmes përdorimit të burimeve dhe duke përdorur me lehtësi fjalorin e përshtatshëm historik; ➤ përzgjedh mjetet e duhura për t'i vendosur të dhënat në tabela, diagrame dhe grafikë; ➤ përdor lehtësisht fjalorin e përshtatshëm për ta bërë mesazhin e tij më të lehtë për t'u kuptuar dhe interpretuar; ➤ përzgjedh dhe përdor mjete të përshtatshme për prezantim; ➤ parashtron pyetje që nxisin debat për temën/çështjen e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes formave të ndryshme të komunikimit.

7.3 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “GJEOGRAFI”

SHKALLA V



Kompetenca I: Hetimi i dukurive gjeografike		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përcakton marrëdhëniet shkak - pasojë të dukurive gjeografike, që ndodhin në sistemet natyrore dhe humane të Tokës; hulumton ndërveprimin ndërmjet mjedisve fizike dhe humane në nivel lokal, kombëtar, rajonal e botëror. Ai formulon dhe drejton pyetje për çështjen gjeografike për të cilën zhvillohet kërkimi gjeografik, spekulon me përgjigjet, duke shpjeguar idetë e tij ose duke formuluar hipoteza. Zhvillon dhe vlerëson çështjen duke përdorur konceptet që lidhen me gjeosistemin, marrëdhënien ndërmjet pjesëve të gjeosistemit, vendin, rajonin, lëvizjen, mjedisin, ndërveprimin.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ identifikon veçoritë e përbërësve të gjeosistemit (atmosferës, hidrosferës, litosferës, biosferës), lidhjen dhe varësinë ndërmjet tyre; ➤ identifikon pasojat e proceseve fizike në modelet dhe sistemet e Tokës dhe në mjedisin human, në nivel lokal/rajonal/botëror; ➤ identifikon modele hapësinore të dukurive dhe proceseve gjeografike dhe shpërndarjen e tyre; ➤ formulon pyetje bazuar vetëm në një aspekt të një çështje ose dukurie gjeografike.	Nxënësi: ➤ përshkruan veçoritë e përbërësve të gjeosistemit (atmosferës, hidrosferës, litosferës, biosferës), lidhjen dhe varësinë ndërmjet tyre; ➤ shpjegon, përmes shembujve të dhënë, pasojat e proceseve fizike në modelet dhe sistemet e Tokës dhe në mjedisin human në nivel lokal/rajonal/botëror; ➤ shpjegon shpërndarjen dhe modelet hapësinore të dukurive gjeografike në shkallë të ndryshme; ➤ formulon dhe drejton pyetje bazuar në disa prej aspekteve të një çështje ose dukurie gjeografike.	Nxënësi : ➤ analizon veçoritë e përbërësve të gjeosistemit (atmosferës, hidrosferës, litosferës, biosferës), lidhjen dhe varësinë ndërmjet tyre; ➤ analizon shoqëruar me shembujt e tij, pasojat e proceseve fizike në modelet dhe sistemet e Tokës dhe në mjedisin human, në nivel lokal/rajonal/botëror; ➤ analizon shpërndarjen dhe modelet hapësinore të dukurive gjeografike në shkallë të ndryshme; ➤ formulon dhe drejton pyetje bazuar në aspektet thelbësore të një çështje ose dukurie gjeografike.
Kompetenca II: Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit		
Përshkrimi i kompetencës:		



Nxënësi identifikon dhe shqyrton burimet e informacionit që përdor për kërkim. Përzgjedh burimet më të përshtatshme nga tërësia e burimeve parësore (intervista, statistika, etj.) dhe dytësore (grafikë, harta, ilustrime, video, CD, internet, etj.), duke vlerësuar në mënyrë kritike vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre. Përdor shkathtësitë gjeografike, mjetet (si hartat, vëzhgimet në terren, fotografi etj.) dhe teknologjinë, për të ndërtuar njohuri për proceset e dukuritë gjeografike në gjeosistem, për rajonet dhe veçoritë e tyre, ndërvlerësinë, bashkëveprimin midis tyre, në nivel kombëtar, rajonal e global; për lokalizimin e tipareve dhe dukurive gjeografike, për të grumbulluar, përpunuar dhe komunikuar informacionin gjeografik. Komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

NIVELI II	NIVELI II	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ ndërton dhe përdor prezantime të thjeshta për të përshkruar marrëdhëniet dhe për të identifikuar modele të thjeshta hapësinore të proceseve dhe dukurive gjeografike; ➤ identifikon informacionin dhe të dhënat gjeografike për të nxjerrë përfundime të thjeshta; ➤ komunikon idetë dhe informacionin gjeografik me shkrim dhe gojë, si dhe në rrugë grafike, duke përdorur në disa raste fjalor të përshtatshëm gjeografik; ➤ përdor burime të rekomanduara të informacionit.	Nxënësi: ➤ përzgjedh, ndërton dhe përdor prezantime të përshtatshme për të përshkruar marrëdhëniet dhe modelet hapësinore të proceseve dhe dukurive gjeografike; ➤ identifikon në burime të ndryshme dhe përshkruan informacionin dhe të dhënat gjeografike për të nxjerrë përfundime bazuar në të dhëna; ➤ komunikon idetë dhe informacionin gjeografik me shkrim dhe gojë si dhe në rrugë grafike, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik; ➤ përdor burime të ndryshme të informacionit, të rekomanduara dhe të identifikuar prej tij.	Nxënësi : ➤ përzgjedh, ndërton dhe përdor prezantime të përshtatshme për të shpjeguar marrëdhëniet, modelet hapësinore të proceseve dhe dukurive gjeografike; ➤ identifikon në burime të ndryshme, analizon dhe interpreton informacionin dhe të dhënat gjeografike për të nxjerrë përfundime dhe evidentuar kufizimet; ➤ komunikon ide komplekse dhe jep shpjegime koherente dhe të qëndrueshme (me gojë, shkrim, në rrugë grafike), duke përzgjedhur gjuhën dhe fjalorin gjeografik; ➤ përdor burime të ndryshme të informacionit dhe gjykon mbi besueshmërinë e vlefshmërinë e tyre.
Kompetenca III: Marrja e vendimeve		
Përshkrimi i kompetencës:		



Nxënësi propozon alternativa, strategji apo zgjidhje për një çështje gjeografike dhe identifikon pasojat që mund të shoqërojnë zgjidhjen e çështjes. Identifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe argumenton qëndrimin e tij në lidhje me to. Përdor pyetje për të reflektuar në çdo fazë të kërkimit: “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet?”.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ➤ identifikon këndvështrime të ndryshme për një çështje gjeografike; ➤ identifikon si vendimmarrja përcaktohet (kushtëzohet) nga faktorë mjedisorë, ekonomikë dhe shoqërorë, në shkallë të ndryshme; ➤ identifikon zgjidhje për një çështje gjeografike aktuale dhe disa ndër rezultatet e mundshme; ➤ identifikon disa ndër pasojat e mundshme të zgjidhjes së përzgjedhur.	Nxënësi : ➤ përshkruan këndvështrime të ndryshme për një çështje gjeografike; ➤ shpjegon si vendimmarrja përcaktohet (kushtëzohet) nga faktorë mjedisorë, ekonomikë dhe shoqërorë, në shkallë të ndryshme; ➤ propozon zgjidhje për një çështje gjeografike aktuale; ➤ përshkruan disa ndër pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar.	Nxënësi : ➤ vlerëson këndvështrimet e ndryshme për një çështje gjeografike; ➤ analizon si vendimmarrja përcaktohet (kushtëzohet) nga faktorë mjedisorë, ekonomikë dhe shoqërorë, në shkallë të ndryshme; ➤ propozon zgjidhje për një çështje gjeografike aktuale mbi bazën e kriterëve të përcaktuara; ➤ analizon pasojat e mundshme të zgjidhjes së propozuar.



8 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “TIK DHE TEKNOLOGJI”

8.1.NIVELET E ARRITJES TIK-U SHKALLA V

Kompetenca: Hetimi me TIK		
Përshkrimi i kompetencës: <i>Nxënësit hetojnë dhe bëhen konsumatorë kritikë të informacionit. Ata hetojnë duke përdorur strategjitë dhe mjetet e duhura</i>		
Niveli II	Niveli III	Niveli IV
Nxënësi: ➤ zhvillon një pamje web për website-n e tij në vijim të strategjive të hulumtuara; ➤ planifikon dhe paraqet kërkime me bibliografi të shënuar ; ➤ analizon burime informacioni elektronike, kritikon besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre; ➤ bashkëpunon për të zgjidhur problemin dhe konkuron me të tjerët në lojrat interaktive edukative; ➤ Punon me një komunitet online për të arritur një qëllim të përbashkët kërkimor duke marrë parasysh përgjegjësinë për të integruar të gjithë anëtarët e komunitetit.	Nxënësi: ➤ harton një website motor dhe përmirëson renditjet e motorëve të kërkimit; ➤ merr në konsideratë burimet parësore dhe dytësore të kërkimit kur citojnë bibliografitë; ➤ vetëvlerëson burimet e veta të informacionit të tilla si website dhe blogje, duke kritikuar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre; ➤ reflekton mbi rezultatet e një loje interaktive edukative ; identifikon strategjitë për sukseset e ardhshme. ➤ krijon dhe punon me një komunitet online për hulumtim reciprok.	Nxënësi: ➤ përdor pajisje data <i>logger</i>, mikroskop dixhital; përdor modele digjitale për të provuar dhe për të përshtatur hipotezat për zgjidhjen e problemave; ➤ krahason të dhënat objektive nga burime të shumta digjitale për të vlerësuar mundshëm besueshmërinë e informacionit të dhënë; ➤ përdor wikis ose dokumenta të tjera të përbashkëta, kërkon baza të dhënash; ➤ demonstroi njohuri për sistemet komplekse pas zgjidhjes së problemit në të cilin dhe në mjediset stimuluese;



		➤ aplikon njohuritë e fituara përmes zgjidhjes së problemit në një mjedis simulimi të një konteksti të jetës reale.
Krijimi me TIK		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësit krijojnë, redaktojnë dhe ndajnë informacion dhe ide. Ata bazohen në konventat e njohura për të shprehur ide dhe informacion.		
Niveli II	Niveli III	Niveli IV
Nxënësi: ➤ krijon, promovon dhe paraqet një transmetim për një audience të gjerë; ➤ merr përgjegjësinë për redaktimin e një elementi të një produkti digjital të prodhuar në bashkëpunim.	Nxënësi: ➤ bashkëpunon për të planifikuar dhe prezantuar një produkt digjital të rafinuar teknikisht që integron aplikime të përshtatshme të TIK-ut ; ➤ menaxhon dhe organizon të dhëna duke përdorur mjete të tilla si mail merge; ➤ mban një koleksion të gjerë të produkteve digjitale që përputhen me konventat e prezantimit të TIK-ut; ➤ përshkruan idetë e tij krijuese dhe harton raportin e vet në lidhje me pronësinë intelektuale; ➤ përzgjedh dhe përdor sisteme menaxhimi të dhënash të përshtatshme për kërkesa specifike.	Nxënësi: ➤ krijon produkte media komplekse, bindëse dhe shumë të individualizuara; ➤ zgjedh, integron dhe vlerëson elemente dhe mjete të projektimit për potencialin e tij për të arritur efektet e dëshiruara; ➤ demonstroi përvoja të specializuara digjitale redaktimi; ➤ diskuton të ardhmen e projektimit të produkteve digjitale; ➤ shpjegon se si të sigurojnë të drejtat ligjore të pronësisë dhe se si të mbrojnë të drejtat e pronësisë intelektuale; ➤ përdor software për të krijuar hiperlinke, tabela dhe skema; ➤ përdor software për hartimin dhe planifikimin e projekteve.



Komunikimi me TIK		
<i>Përshkrimi i kompetencës: Nxënësit aftësohen të shprehin identitetin, komunikojnë në mënyrë të përshtatshme dhe ruajnë sigurinë dhe privatësinë. Ata kontribuojnë dhe mësojnë nga të tjerët.</i>		
Niveli II	Niveli III	Niveli IV
Nxënësi: ➤ promovon respekt për veten dhe të tjerët në komunikime; ➤ diskuton sfidat në lidhje me shfaqjen, parandalimin dhe kontrollin e krimit kibernetik; ➤ kupton shqetësimet e paraqitura nga rrjete të veçanta online; ➤ planifikon një projekt këmbimi online, e zbatojnë atë dhe tërheqin pjesëmarrësit në të.	Nxënësi: ➤ identifikon mënyrat e TIK-ut që mund të përdoren për të promovuar të drejtat e njeriut; ➤ demonstron mirëkuptim të legjislacionit të krimit kibernetik; ➤ krahason dhe vlerësojnë se si rrjete të ndryshme online mbrojnë identitetin; ➤ zgjedh dhe rekomandon zgjidhje software bashkëpunuese të përshtatshme për qëllime të veçanta; ➤ bën rekomandime për përdorimin etik të pajisjeve të reja.	Nxënësi: ➤ përdor aplikacione online dhe mjetet e menaxhimit për projekte bashkëpunuese të tilla si portalet online, wikis; përdor mjetet e përbashkëta të rrjeteve sociale për qëllimet strategjike; ➤ kupton avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të website-ve dhe mjediseve online për menaxhim dhe bashkëpunim; ➤ lehtëson punën në grupe me software dhe bashkëpunon për të gjetur mjete për menaxhim projekti; ➤ krahason dhe vlerëson teknologjitë e reja për ndikimin ndaj çështjeve që ata paraqesin.
Menaxhimi dhe Oeprimi me TIK		
<i>Përshkrimi i kompetencës: Nxënësit përdorin procedurat e njohura për të mbajtur një mjedis TIK të sigurtë, të mbrojtur dhe efikas.</i>		



Ata kuptojnë se si sistemet dhe komponentet TIK janë përdorur për të ruajtur dhe rifituar informacionin.		
Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
Nxënësi: ➤ përshkruan rreziqet specifike të sistemit të tilla si: mosfunksionimi i celularit dhe se si ti heqin ato; ➤ analizon dhe krahason përgjegjësinë e TIK –ut duke përdorur politikat e organizatave të ndryshme; ➤ bën dallimin ndërmjet funksioneve të sistemeve operative software dhe aplikacioneve software; ➤ përshkruan tiparet kryesore të rrjeteve të një sistemi operativ të tilla si kontrollin e aksesit, shërbimet e dosjeve dhe shkëmbimi.	Nxënësi: ➤ demonstroi njohuri dhe kuptojnë të rejtat e fundit të sigurisë TIK; ➤ diagnostikon defektet kompjuterike, i riparoi ato dhe përmirëson sistemet; ➤ krahason sistemet e përbashkëta të lidhjes të tilla si dial-up, ADSL, Wireless Broadband; ➤ demonstroi menaxhim efikas dhe efektiv të skedarëve; ➤ kupton se si një kompjuter kryen logjikën digjitale (duke përdorur sistemin e numrave binarë.) ➤ merr pjesë në hartimin dhe ndërtimin e rrjetit.	Nxënësi: ➤ zgjedh opsionin e duhur për krijimin e një faqe interneti të tillë si një mjet online ose editor HTML; ndryshon Toolbars; klasifikon dhe paraqet funksionet; përdor printimin duplex; përdor filtra për të devijuar postën e padëshiruar; optimizon funksionet dhe tiparet e mjeteve online për një qëllim të caktuar; ➤ harton dhe përdor konvencione file/folder të qëndrueshme me emërtime; mirëmban versionin e kontrollit të dokumenteve; kufizon aksesin e të dhënave nga lokacioni ose fjalëkalimi; ➤ zbaton njohuritë e tij për të vendosur nëse do të përdorë cloud, server lokal ose storage; nëse do të përdorë webcam apo kamera digjitale.
Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike për përdorimin e TIK-ut		



Përshkrimi i kompetencës: Nxënësit Njohin pronësinë intelektuale dhe aplikojnë praktika të sigurisë së informacionit digjital. Ata aplikojnë protokollet personale të sigurisë dhe identifikojnë ndikimin e TIK-ut në shoqëri.

Niveli II	Niveli III	Niveli IV
Nxënësi: ➤ në mënyrë të pavarur aplikon strategjitë e duhura për të mbrojtur të drejtat, identitetin, jetën private dhe sigurinë emocionale të tjerëve gjatë përdorimit të TIK-ut; ➤ vlerëson ndikimin e TIK-ut në vendin e punës dhe në shoqëri; ➤ krijon imazhe të thjeshta duke përdorur komandat fillestare të programeve; ➤ krijon faqe të thjeshta , por me shumë gabime.	Nxënësi: ➤ demonstroi menaxhim efikas dhe efektiv të skedarëve ; ➤ kupton se si një kompjuter kryen logjikën digjitale (duke përdorur sistemin e numrave binarë); ➤ vlerëson rreziqet që lidhen me mjediset online dhe krijon strategji të përshtatshme të sigurisë dhe kodeve të sjelljes; ➤ diskriminon mes protokolleve të përshtatshme për mjete të ndryshme të komunikimit kur bashkëpunon me komunitetet lokale dhe globale; ➤ diskuton për rolin e TIK-ut në të ardhmen dhe se si ai mund të ndikojnë në përdorimin e tij.	Nxënësi: ➤ kupton licensimin e krijimeve të përbashkëta; ➤ përdor parametrat komplekse të sigurisë për faqet online; ➤ ndryshon fjalëkalimin e strukturave; ➤ ndan informacionin me dosjet apo faqet dhe kupton se si të modifikojë parametrat e parazgjedhura brenda faqeve e rrjeteve sociale; ➤ analizon pasojat e mundshme të postimit të informacionit personal në faqet e rrjeteve sociale; ➤ merr përgjegjësinë për efektin e komunikimit të tyre me njerëzit e tjerë; ➤ njeh rritjen e potencialit të përfshirjes për njerëzit me aftësi të kufizuara nëpërmjet TIK-ut, ndarjes dixhitale, llojeve të reja të punës, globalizimit.



9 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “EDUKIMI FIZIK, SPORTE DHE SHËNDETI”

SHKALLA V		
Klasa X		
Kompetenca I: Shfaq aftësi lëvizore në përshtatje me situata të ndryshme lëvizore e sportive		
Përshkrimi i kompetencës: Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit njohin dhe ekzekutojnë përmes: koordinimit, rregullimit, kontrollit, ndjesive dhe shprehive, të cilat i referohen aftësisë për të ekzekutuar veprime të ndryshme lëvizore (përkulje, rrotullim, hedhje, ngritje, vertikale, zvarritje, fluturim, lekundje, kaperdimje) e cila zhvillohet në situata të larmishme të të nxënit të lidhura me lloje të shumta aktiviteteve si p.sh: kombinime me përmbajtje të lëvizjeve lokomotore (vrpimi, ecja, notimi, çiklizmi, etj.) dhe lëvizje jolokomotore si (kërcimi, goditja, xhonglimi, etj.), lëvizje manipulative me dhe pa mjete, kombinime teknike e artistike (gjimnastika artistike e ritmike).		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ➤ <i>demonstron</i> elementë teknikë sipas disiplinave sportive; ➤ <i>demonstron</i> elemente të kombinacionit lëvizor me dhe pa mjete (<i>cirkuide, stafeta</i>); ➤ <i>demonstron</i> elementë akrobatike të thjeshtë; ➤ <i>demonstron</i> pjesërisht lëvizje ritmike me numërim;	Nxënësi: ➤ <i>zbaton</i> kombinime të elementëve teknikë në situata lëvizore; ➤ <i>zbaton</i> kombinacione lëvizore me përmbajtje të aftësive lëvizore bazë, të manipulimit lëvizor me dhe pa mjete (<i>cirkuide, stafeta</i>); ➤ <i>zbaton teknikën</i> e elementëve akrobatike gjatë kombinacioneve lëvizore ;	Nxënësi: ➤ <i>zotëron</i> teknika lëvizore dhe kryen kombinime në situata të ndryshme sportive; ➤ <i>zotëron</i> aftësi mbi zhvillimin e kombinacioneve lëvizore me përmbajtje të aftësive lëvizore bazë, të manipulimit lëvizor me dhe pa mjete; ➤ <i>zotëron</i> aftësi mbi zhvillimin e kombinacioneve me elementë akrobatikë të thjeshtë e të kombinuar me lëvizje artistike;



➤ <i>identifikon</i> shenjat e gjëndjes së varësisë nga substancat droga, si dhe pasojat në organizmin e njeriut.	➤ <i>argumenton</i> shenjat e gjëndjes së varësisë nga substancat droga, si dhe pasojat në organizmin e njeriut.	➤ <i>harton dhe projekton</i> plane mbi rolin që luan veprimtaria fizike ndaj fenomeneve negative(alkoli,droga ,duhani etj.); ➤ <i>harton dhe projekton</i> plane për shmangien dhe rehabilitimin e gjëndjes së varësisë nga substancat droga, si dhe pasojat në organizmin e njeriut.
--	---	--

